

BIBLIOTEKA

854-1  
A 85



# ALI ASLLANI

POEZI TË ZGJEDHURA

BSH-1

A 85

**Ali Asllani**

**POEZI  
TË ZGJEDHURA**

Përgatiti: JORGO BLLACI



SHTËPIA BOTUESE "NAIM FRASHËRI"  
Tiranë, 1996

## MIKU I TË GJITHËVE, ALI ASLLANI

**K**aluan tridhjetë vjetë nga dita kur mbylli sytë njera nga krenaritë e poezisë shqipe, njeriu që e kam dashur aq shumë, mësuesi im, zemërbardhi Ali Asllani. Aso kohe isha i burgosur dhe më mbeti peng që nuk munda t'i hidhja një grusht dhe mbi varr. Megjithatë jo rrallë herë më duket sikur ai nuk ka vdekur, sikur është gjallë po ka ikur diku për t'u kthyer sërishmi. Dhe këtu nuk e kam fjalën për pavdekësinë e tij si poet, sepse këtë ai e kishte arritur shumë vite më parë nga dita e zezë e atij pragdimri të zi të viti 1966, por për figurën e tij si njeri: i butë, i thjeshtë, i sjellshëm, elegant, megjithëse i varfër e në moshë tepër të thyer.

Një paradite aty nga fundi i viteve '50, isha ulur në ish kafën "Vollga" në Tiranë për të bërë korrekturën e disa vjershave që do t'i dërgoja në një gazetë. Në lokal kishte shumë pak njerëz. Tek po punoja, më tërhoqi disa herë vëmendjen një burrë tepër i moshuar, i vetëm te tavolina afër meje, që nuk po m'i ndante sytë. Kur vuri re shqetësimin tim, ai më pyeti pak si i drojtur: "më falni, vjersha i keni ato?" Pohova me kokë. "Jam

marrë edhe unë me vjersha, - vijoi ai po me atë drojtje, - mund t' u hedh një sy?" "Me kënaqësi, - ia ktheva dhe i zgjata fletët që kisha përpara, - veçse janë shtypur me shumë gabime... Po, më falni, - kësaj here ndjeva unë një farë drojtje prej tij, - me cilin kam nderin?..." "Mbase ke dëgjuar për një poemë..." "Ali Asllani!" - e ndërpreva unë me atë entuziazmin e njëzetvjeçarit dhe vajta u ula te tavolina e tij. Ai filloi të lexonte. Disa minuta prita gjithë ankth përshtypjet e tij. Si mbaroi, më hodhi një vështrim të ëmbël e më tha: "do t' i botosh dot?..." Ajo s' ka rëndësi, - ia ktheva, - mua më duhet ç' thotë për to Ali Asllani...". Qeshi. "Pse kaq trishtim, - mëmëriti dhe rrudhi pak ballin, - në moshën tënde nuk duhet kënduar kështu... megjithatë ke vargje të ndier... Kjo e fundit për Frosinën e Ali Pashait, më pëlqen vërtet..." Atë çast më erdhën ndër mend ato ç' ka pata dëgjuar nga pedagogët e fakultetit, se Ali Asllani, më shumë se poet është një lloj rapsodi lab dhe, pa i peshuar mirë fjalët, e pyeta: "mos vallë ajo vjershë ju pëlqen se ka kadencën e tetërrokshit popullor?". U mvrejt' dhe si u mendua pakëz, ma ktheu: "unë i njoh fare mirë të gjitha metrat e poezisë botërore. Kam lexuar shumë poetë, disa edhe në origjinal... po nuk ta kam fjalën këtu. Vjershën nuk e bën metrika. Atë e bën zëmra dhe kjo zëmër këndon më e çpenguar në avazin e këngëve që je mësuar t' i dëgjosh që me sisën e mëmës. Në qoftëse poetët francezë, psh. që unë i dua shumë, shkruajnë me vargun aleksandrin, ai është vargu i tyre kombëtar,

siç është për sllavët dhjetërrokshi, apo siç është për ne gjashtë e tetërrokshi. Brumin duhet ta marrësh nga magjja jote. Zotësia është që nga ky brumë të na bësh bukë të mirë... E di se ç'ke dëgjuar për mua... bejtexhi, thonë..."Ndjeva që u skuqja dhe i thash se atë pyetje nuk ia bëra i shtyrë nga ndonjë paragjykim. Përkundrazi, poezinë e tij e çmoja shumë dhe isha me të vërtetë i lumtur që pata rastin ta njihja për së afërmi.

Qysh nga ai çast, për vite me radhë, takoheshim pothuajse për ditë. Diferenca tepër e madhe e moshave nuk na pengoi të bëheshin miq të mirë e t'i hapnin njeri tjetrit skutat më të thella të shpirtit. Bënte një jetë tepër të varfër duke i shtyrë ditët me rrogat e vogëla të fëmijëve, njeri prej të cilëve i sëmure rëndë nga mushkëritë, banonte në një shtëpi gati më të shembur në krye të rrugës "Luigj Gurakuqi". E megjithatë nuk e jepte vehten. Rrallë mund të shihje ndonjë burrë në prag të tetëdhjetave të mbahej si ai: i pastër, i hekurosur e me atë shtat lastar të drejtë.

Nëpër biseda nuk kishte atë zakonin që kanë pleqtë për të folur vetëm ata, kurse të tjerët vetëm të dëgjojnë. Përkundrazi, xha Aliu (se kështu i thërrisja dhe kështu ma do zemra ta quaj edhe sot) ishte tepër i matur dhe kur fliste, fjala i kishte peshë. Kur të tregonte diçka nga jeta, dhe jeta e tij ishte plot ngjarje, meritat mundahej t'i ndante gjithëmonë me të tjerë. Sa herë binte fjala psh. për luftën e Vlorës më 1920, megjithëse shoqëria "Përlindja Kombëtare" e ngarkoi me detyrën e hartimit të programit, kurse komiteti "Mbrotjta

Kombëtare" si "Kryetar të Katundarisë së Vlorës", megjithëse poezia e tij "Vlora, Vlora" u bë hymn e kushtrim në luftën për dëbimin e okupatorit, megjithëse pikërisht për këto kontribute u izolua prej pushtuesve në ishullin e Sazanit, ai përmendte gjithëmonë mençurinë, vetëmohimin e trimërinë e Osman Haxhiut, Qazim Koculit, Halim Xhelos, Jani Mingës, Harilla Kolekës etj..."Ata ishin prinjësat, - theksonte ai, - ne të tjerët bënim detyrën".

Në disa parathënie e pasthënie të librave të tij, botuar pas vitit 1962, si dhe në disa monografi, më ka rënë në sy një pasaktësi (të mos them dashakeqësi) për qëndrimin e poetit ndaj okupatorit fashist. Thuhet se gjatë kohës së Luftës N.ÇI, ai ishte anëtar i Këshillit të Naltë të Shtetit. Në fakt, këtë emërim e ka marrë para zbakimit të trupave fashiste në trojet tona. Vërtet emri i tij figuron në listën e atij këshilli, madje edhe në atë të dërgatës që do t'i shpinte Viktor Emanuelit në Roma kurorën e Skënderbeut, por vetë ai, në shenjë proteste ndaj pushtimit, u tërhoq nga jeta politike, braktisi kryeqytetin dhe vajti në fshatin e prindërve të tij, në Vajzë të Vlorës.

"Në Vajzë - më tha një ditë, - më erdhi aty nga fillimi i dyzetëdyshit një nga udhëheqësit e nacional-çlirimtares dhe si më falënderoj për qëndrimin antifashist, më kërkoi të jepja edhe unë kontributin tim në luftën për çlirim. Jam plak, - i thashë, - dhe nuk jam për dyfek. Po ti ke një armë më të fortë se dyfeku, - më tha ai, - ke penën. Lufta ka shumë nevojë për penën

tënde. Dhe unë shkrova ahëre këtë vjershë, që ata të nacional-çlirimtares e shpërndanë me traktet e tyre”.

Në atë çast xha Aliu nxorri nga xhepi portofolin, e hapi dhe shpalosi dy letra të zverdhura nga koha e gjithë dhëmbëza nëpër skajet e palosjes. “Këndoje” - më tha. Ishte një poezi e gjatë, me titull “Hakërrim”. Deri ahëre kisha dëgjuar nga goja e tij vjersha lirike, veçanërisht erotike, që më kishin lënë të magjepsur, por ajo poezi më tronditi. Padyshim ishte më e fuqishmja që ishte shkruar gjatë luftës. “Dhe këtë, - i thashë, - e ka shkruar në fillim të dyzetedyshit Ali Asllani, që sot nuk ka triskë fronti, që sot nuk ka as pension e as shtëpi?! Po kjo është e tmerrshme! U ngjita menjëherë në katin e dytë të bar-hotel “Vollgës” ku ndodheshin zyrat e administratës, u luta të më lejonin disa minuta të daktilografoja diçka dhe e shtypa atë poezi në disa kopje. Kur zbrita në kafe, i thashë xha Aliut se dy kopje do t’i mbaja unë, kurse dy të tjerat, bashkë me origjinalin, ia dhashë atij. Dy kopjet e mia kaluan zyrë më zyrë e aparat më aparat, deri së më në fund poezia pa dritën e botimit në revistën “Nëntori”. Më pas filluan t’i botohen edhe libra, po për to, poetit të gjorë iu desh të paguante edhe haraçin me ndonjë vjershë për të ashtuquajturën “kohë e re” që gjithësesi nuk ia ul vlerën korpusit madhështor të veprës së tij.

Pasaktësi të shumta në ato ç’ka janë shkruar për poetin ka edhe lidhur me marrëdhëniet e tij me kolegët bashkëkohës. Në pasthënien e botimit 2 vëllimësh të “Rilindjes” së Kosovës, magistër Kajtaž Recaj shkruan

se, siç i ka kumtuar kritikun Razi Brahimi që ka biseduar personalisht me poetin, ai nuk e çmonte Fan Nolin, sepse kishte vargëzuar tema biblike, që nuk kuptoheshin nga lexuesit. Mund ta siguroj autorin e asaj pasthënieje se ai kumtim është thjesht trillim i Razi Brahimit, i njohur për hedhje balte mbi shumë personalitete. Për xha Aliun, bibla ishte vepra më e bukur që ka krijuar gjenia njerëzore. Ai e njihte atë fort mirë dhe i referohej jo rrallë nëpër biseda. Kurse Nolin e konsideronte personalitetin më përfaqësues të kulturës shqiptare. Poezitë "Elegji për Luigj Gurakuqin", "Hymni i Flamurit", "Elegji për Bajram Currin" dhe "Tomsoni dhe kulçedra", i dinte përmendësh, madje këtë të fundit e citonte shpesh si kulm të forcës dhe muzikalitetit të fjalës shqipe.

Miku im shumë i nderuar, kunati i poetit, Engjëll Kokoshi, më besoi gjithë dorëshkrimet, dokumentet dhe fotografitë që ka ruajtur familja, të cilat, si shtëpi botuese, do t'i përdorim për botimin e korpusit të plotë të Veprës së Ali Asllanit. Por, ndër fotografitë, mungon njëra e fillimit të viteve 30 në Athinë, të cilën poeti e ruante si gjënë më të çmuar: ajo ku ka dalë me Gjergj Fishtën, poetin nobelist indian Rabindranat Tagora dhe me klasikun e poezisë greke Kostis Pallas.

"E thirra Fishtën në Athinë, kur isha ministër, të kalonte aty nja dy javë, sepse kisha ftuar edhe Tagoren e famshëm. E porosita të kalonte në Pogradec e të merrte me vete edhe Lazgushin, se edhe atë e doja shumë, po Fishta nuk kaloi fare nga Pogradeci dhe



erdhi vetëm, gjë që më dëshpëroi vërtet. Por kaluam mirë...”

Se sa i nderonte ai kolegët dhe në përgjithësi personalitetet e kulturës, e dëshmon korespondenca me shumë prej tyre, e cila shpresojmë t’i bëhet e njohur shumë shpejt lexuesve.

Xha Aliu ishte shumë i dashur me të gjithë. Tërë rrethi i shokëve dhe miqve të mi u bënë shumë shpejt edhe miqtë e tij. Ndoshta nga rrethanat, a ndoshta nga vetë natyra e tij, nuk i pëlqente të bisedohej për politikë. Sa herë që e shkelte ndokush këtë kërkesë të tij, ai menjëherë do të ndërhynte me shprehjen karakteristike “amore e felicità!”. Kush e pati njohur do ta kujtojë gjithëmonë për humorin e tij plot finesë. I pëlqente të hiqej ashik edhe pse ishte aq shumë i thyer në moshë, sigurisht për të na ardhur pas avazit neve të rinjve.

Një ditë, tek po hynin në sallën e klubit të shkrimtarëve, që aso kohe ndodhej pranë Teatrit Popullor, ai na kërkoi disa sekonda leje dhe u ndal te një grup aktorësh, midis të cilëve ishte edhe Afërdita Taçi, ahëre në zenithin e saj të bukurisë. “Më falni, zonjushe, - iu drejtua asaj, ndonse nuk e njihte, - a mund të më thoni: kur do vinë dallandyshet?” Ajo u skuq e vuri buzën në gaz, ndërkohë që plaku erdhi e u bashkua triumfalisht me ne.

Gjithënjë për humor, herë herë na mbahej si “burrë zamani”. Po të kthenim ndonjë gotë diku në ndonjë lokal, do të bënte sikur mvrejtej e do të na thoshte:

“tani, vemi e rrahim gratë?”

Kujtimet për të nuk kanë të sosur e mbase do të kërkonin një libër më vehte. Në këto pak radhë, në vend të parathënies së këtij botimi jubilar, mund të them vetëm kaq: ai ishte njeri me tërë kuptimin e fjalës, atdhedashës, erudit (zotëronte frëngjishten, turqishten, italishten e greqishten) e me pikëpamje iluministe (autori i tij më i dashur ishte Volteri). Kurse si krijues, veçanërisht në poezinë e dashurisë, këtë e them me plot gojën, është mjeshtri më i përsosur i poezisë shqipe. Për fat të keq, kritika jonë tej mase e politizuar e ka anashkaluar këtë vlerë të padiskutueshme të këtij vjershëtori, që qëndron me dinjitet përkrah mjeshtrove të lirës shqiptare, Naimit, Fishtës, Nolit, Mjedës, Lazgushit e Migjenit.

Në këtë vëllim jam përpjekur të përzgjedh ato krijime që vetë poeti i kishte më për zemër e që mendoj se e përfaqësojnë më mirë personalitetin e tij artistik. Ndonjë mangësi do ta plotësojë botimi i tërë veprës së tij.

Le të jetë ky botim një homazh për veprën e tij të çmuar dhe një pikënisje për një rivlerësim të saj nga studiuesit dhe historianët e letërsisë.


**Jorgo BLLACI**



Ali Asllani

Atelier Photographique  
KOL MAZZA  
Scutari d' Albanie

Ali Asllani



## PAK BIOGRAFI

**A**li Asllani u lind në janar të vitit 1882 në Vlorë, në një familje të shpërngulur nga fshati Vajzë.

I ati, Asllan Sulejmani, pasi mbaroi studimet e larta për teologji në Stamboll, u caktua myfti-myderiz i Vlorës, por vdiq duke e lënë poetin e ardhshëm 6 vjeç. Tre vjet më vonë vdes edhe e ëma Hyri. Për jetimin u kujdesën kushërinjtë. Ai vazhdoi shkollën fillore në Vlorë e më 1908 gjimnazin e Janinës. Më pas, fitoi konkursin e pranimit në Mylqie, instituti i lartë i Shkencave Politiko-Shoqërore -Administrative të Stambollit dhe pasi mbaroi studimet, u dërgua për të kryer stazhin në prefekturën e Janinës. Më 1908 zëvendësoi për tre muaj nënprefektin e Delvinës dhe u kthye përsëri në Janinë, ku ishte dhe njëri nga anëtarët më në zë të Klubit "Bashkimi". Atje për mbështetjen që i bëri figurës liridashëse të Ismail Qemalit filloi të persekutohej nga organet qeveritare turke, madje u dha urdhër të internohej në Halep të Sirisë. Ai mundi t'i shpëtonte internimit, kaloi në Korfuz e prej andej në Vlorë. Më pas mori pjesë në Kuvendin

e Dibrës si përfaqësues i klubit "Bashkimi" të Janinës. Më 1910, pas rënies të kabinetit turk, që e internoi, u kthye në Stamboll. U emërua sërish nënprefekt, por me kusht që të mos shërbente në tokat shqiptare. Deri nga fundi i vitit 1912 punoi si nënprefekt në Akseqi, Ellgen dhe Boskër të vilajetit të Konjës në Anadoll. Pasi mori lajmin e ngritjes së flamurit në Vlorë, u largua menjëherë nga Konja dhe u kthye në vendlindje. Ismail Qemali i besoi detyrën e sekretarit të përgjithshëm të Presidencës e të Këshillit të Ministrave, detyrë në të cilën qëndroi deri më 22.I. 1914. Më pas punoi për disa kohë si nënprefekt i Fierit e Kajmekam i Ballshit. Pas largimit të princ Vidit, shkoi për disa javë në Itali e pastaj u kthye në Vlorë, ku nga administrata lokale caktohet sekretar gjeneral (10.11.1915 deri 1.1.1917). Pushtimi italian i Vlorës e gjeti nënprefekt të qytetit, por duke qenë se ai protestoi zyrtarisht për këtë pushtim, komandanti i trupave italiane e pushoi nga kjo detyrë. Më pas, pas marrëveshjes për ndryshime administrative, me këmbënguljen e organizatës "Mbrojtja Kombëtare" u caktua Kryetar bashkie i Vlorës (20.12.1918 deri 5.11.1920). Në vitet 1921-1922 ishte kryekëshilltar i qeverisë. e më pas sekretar i përgjithshëm i kryeministrit. Më pas u caktua konsull në Trieste, ku qëndroi deri në fund të prillit të vitit 1925. Po atë vit u emërua "Zëvendës i ngarkuar me punë" në Sofje e më pas, po aty, "sekretar i parë" dhe " i ngarkuar me punë". Në vitet 1930-1932 u ngarkua me

detyrën e ministrit të akredituar në shtetin grek. Më 1934 u caktua kryetar bashkie në Vlorë deri në prag të pushtimit fashist, kur u emërua anëtar i Këshillit të LArtë në Tiranë. Pak kohë më pas u largua nga jeta politike dhe vajti në fshatin Vajzë të Vlorës. Pas çlirimit, u bë njëri nga themeluesit e Lidhjes së Shkrimtarëve. Deri në vitin 1952 mbahej me të ardhurat e pakta nga përkthimet për llogari të Institutit të Shkencave, por edhe kjo mundësi iu pre. Pak vjetë para vdekjes, më në fund u botuan disa libra të tij dhe iu lidh një pension i vogël. Mbylli sytë më 1966.

BARDHOSH GAÇE

55138

17






*Ali Asllani me te shoqen, kur ishte konsull në Trieste*



**VAREN ESHTRAT E  
SHQIPTARËVE NËPËR  
SQEPA TË SQIFTERIT**



## **DËSHPËRIM DHE SHPRESË**

*Edhe sot e këtë orë,  
edhe sot ajo stuhi,  
ajo flamë-madhe dorë  
do na bëjë tym e hi!*

*Komb i varfër, komb i gjorë  
si një zok i pafolë,  
një pullumb i bardhë borë,  
ngeli keq në një rrëke!*

*Që nga Korça gjer te Shkodra  
fat'i vëndit errësirë,  
nëpër fusha, nëpër kodra  
fryn e çfryn një egërsirë.*

*Komb i varfër, komb i mjerë,  
i pamëm'e pa-atë,  
shpresa jote këtë herë  
si një flet'në deg'të thatë!*

*Komb i varfër, komb i mjerë,  
derëzi e punëzi,  
edhe sot si kurdoherë,  
një njeri i panjeri!*

\* \* \*

*Jo, se, ja dhe hëna mbrëmë,  
dukej kredhur në një rrobë,  
edhe nxinte si një mëmë  
që ka mbetur qyqe korbë!*

*Mirpo sonte bukuri,  
buz'e saja burim gazi,  
dhe nga gjiri saja zbraz  
vargje vargje drit'flori!*

*Nuk e di se qysh dhe si,  
nuk e di se qysh nga se,  
po nashti një shpres'e re,  
shtin e shkrep në sy të mi.*

*Do na zhduket errësira,  
do të zhduket ajo dorë,  
nesër vjen me shum' të mira  
shkaba jonë dykrenorë.*

*Nënë hijen e asaj  
paravera është'përhera,  
që nga fundi gjer në maj'  
rreth e rrotull ylyvera.*

*An'e mbanë bukuri,  
komb i lirë, tok'e lirë,  
shqipëtar e Shqipëri,  
sa të lumtur, sa të mirë!*

## **VARRIMI I ISMAIL QEMALIT**

*Si u bë? Ashtu si bëri,  
fis'i Vlorës rrjeth prej drëri...*

*Ishte dita nëntë shkurt,  
nëntë shkurt nëntëmbëdhjetë,  
nënë grusht të huaj të gurt!  
do varrosej Plaku i shkretë!*

*Po varrosej Plaku Math,  
dy taborë u bënë garth,  
dy tabor' ushtar' të huaj,  
një karroc'me tetë kuaj.*

*Kur..mbi arqe ku ish Plaku  
u duk ngjyr'e një bajraku...  
Ish bajraku Italisë!  
Gjëmoi zër'i djalërisë!*

Na u duk se Plaku vet  
nëpër heshtje diç na pyet,  
sikur pyeti më përpara  
"Ku është flamuri që vara?"

Gjëmoi zër'i djalërisë:  
"Posht bajraku trikolor!  
rroft flamuri dykrenor!"

- Kape, zure e përzure...  
tao, tao ca kobure...  
Vlora dife plot me duf  
atë çast ja bëri buf!

Bajonetat i përbuzi,  
dhë me vrull të një topuzi  
dër' e saja ra mbi arqë!  
Kumandani me dy faqe

menjëher' ndërroi fletë  
bëni - tha - si doni vetë,  
vini ju bajrakun tuaj  
nuk ndërhyt në pun'të huaj!

Vlora bëri si e deshi,  
me bajrak të saj'e veshi,

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*veshi Plakun me bajrak  
me bajrakun ngjyrë gjak!*

*Me një shkab'të zez'në mes,  
dhe i vdekuri që s'vdes  
mori udhën për në Vlorë...*



## **BUZA IME KUR DO QESHË?**

*Edhe sot po ajo re,  
ajo re, po nëpër të  
duket çel' e hap një gjë,  
duket çel'një koh'e re,*

*Jo, ajo është edhe sot,  
ajo koh'është'koh'e ligë,  
zuri prapë juga shtrigë,  
shpresa ime është'e kotë!*

*Shpresa ime si një yll  
rrëzë reve shënëndreut,  
diku shquan nga faq'e dheut,  
aty hap e këtu mbyll.*

*Dimër kemi apo verë,  
çfar'të them e more vesh?  
Ku është'shkaba me dy krerë.  
buza ime kur do qesh?*

*Buza ime do të qeshë,  
kur do bëhet li e leshë,  
në se armët rrok arbreshi  
buz'e kombit do të qeshi!*

## **KUSH MBAN ARMË TË ERGJËNDA**

*Kush mban armë të ergjënda,  
do kobure, një harbi,  
kush vaporet nëpër tënda  
rreth e rrotull dhen'e dhi?*

*Kush ja thot'në ata pyje,  
flet me re e flet me yje,  
pyje thane, pyje lisi  
këndon këngën e një fisi?*

*Kush jep kokën dhe mban besën  
ç'jan'ata që din'e vdesën,  
ç'jan'ata që dor'e zotit  
u dha zjarrin e barotit?*

*Këta daull', i than':ndal!  
gjalmëzeza ka bër'djal',  
ka bër'zok edhe sqyfter  
pra në vetull gjak të mer!*

*Ka bër'zoq edhe sorkadhe  
çepezes, po faqebardhë,  
nuk branisen nëpër këmbë.  
e han'hekurin me dhëmbë!*

*Kështu than'edhe i ran'  
gur më gur e stan më stan,  
lum kush paska jataganë  
lufton Sparta me Persanë!*

*Lufton Sparta me një mbret  
që dhe valave në det  
u vërsulej me dajak!  
me miljona prishanak,  
në një dorë dy mizrak  
sa që deti bëhej gjak!*

*Një Leonidh'me treqind veta  
kësaj bote byt shigjeta  
u dha dërmën e i sosi  
në det brënda i varrosi.*

*Vlor'e sotme Spart'e vjetër...  
Shqipëri e s'ka më tjetër!  
Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
bjeri moj t'u lumtë dora!*

\* \* \*

*Andej bomba dhe ballonë  
mitralozë dhe vaporë,  
një flamur këtej valonë,  
udhëtonte për në Vlorë!*

*Andej krisma, gjyle, topa  
vinin rrahin fush'e male,  
këtej pallat copa copa  
dhe koburet me stërallë!*

*Andej bomba, bajoneta  
pirgje pirgje radhë radhë,  
këtej vetëm e vërteta  
edhe burrat faqebardhë!*

*Ai dridhej e përdridhej  
nëpër tënda i stolisur,  
ky me gjith'fëmijë mblidhej  
në një çull të dhir'të grisur!*

*Ai kish sa bën rrëmujë,  
ja dërgonin dhe me tela,  
këtij rrall'një farmak ujë  
ja bij nëna me buciela!*

*Ai rreth e rrotull hekur,  
ha e pi e vish e ngjish,  
ky në gërje, duke vdekur,  
e fshin gjakun me këmish'!*

*Më së fundi shkrepë ahu,  
dhe e drejta shkrepëtijti,  
u duk tymi atij krahu,  
i qëlloi e i goditi!*

*Më së fundi derdhi Dielli,  
derdhi Dheu, derdhi Qielli,  
derdhi dritën më të mirë,  
Proftë Vlora jon'e lirë!*

## **VLORA, VLORA!**

**(Pjesa I - para luftës)**

*Jam vlonjat e jam vlonjat,  
e kam shkabën mëm'e atë,  
shkaba trime dykrenore  
fron'e saj'e ka në Vlorë!*

*Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
rroki armët, bëja fora!*

*Vlora trime shqipëtare  
si rob jetën s'e do fare,  
a do mbetet Shqipëri,  
a do bënet tym e hi!*

*Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
rroki armët, bëja fora!*

*Jam vlonjat e jamte burrë,  
s'duron burri zgjedhë kurrë,  
jam vlonjat e si vlonjat  
di bëj luftë me të shtat'!*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,  
Bjeri, moj, t'u lumtë dora!*

*Jam vlonjat dhe trim me besë,  
rreth flamurit di e vdesë,  
a me hir'a me pahirë  
doemos do rroj i lirë!*



## **FLAMURIT KOMBËTAR**

*Kur se erret dor'e Zotit, na ndes Yjet nëpër qiejë;  
Vala jote madhështore, na ndes gjakun nëpër deje;*

*Vala jote madhështore..*

*Tregon armet arbënore,*

*Ngjyr'e kuqe trgon sheshit,*

*Tregon gjakun e arbreshit.*

*Tregon gjakun e arbreshve, faqe bardh'e çepezes,*

*Për të mbajtur ty mbi supe, van'u thyen të gjith'në mes;*

*Që të gjith'në mes u thyenë;*

*Po kujtim i tyrej vlenë,*

*Vlen sa syri mu në ball,*

*Për një Komb që është i gjall.*

*Ti je tash nga dor'e tyrej, më i madhi amanet;*

*Amanetin - thot arbreshi - edhe toka nuk e tret;*

*Sa të roj e sa të jetë,*

*Gjir i qiellit plot me Yje,*

*Ty shqiptari do të ketë,*

*Si ka diellin përmbi krye;*

*Si ka diellin si ka Hënën,*

*Mu si foshnja që ka nënën;*

Mu si nëna që ka djalën,  
Mu si burri që ka fjalën.  
Deri dije një shqiponjë, bij', mbes'në gur të that,  
Luft me sqep e luft me thonjë, luftëtare me të shtat;  
Deri dije një shqiponjë,  
Luftëtare me të shtat;  
Tash e tutje rrofsh si zonjë,  
Të buroft'nga buza mjalt'.  
S'ka më mir'nga buza mjaltë, s'ka më mir'zëmr' e  
pastër;  
Jemi rritur në një djepe, jemi thekur në një vatër;  
Kemi gjakun më të situr;  
Si dhe zogjt e dallandyshes;  
Ky bulmet që na ka rritur',  
Ka pikuar nga gjir i gjyshes.  
Pra të gjith për njeri tjetrin mjalft'na buz'e shpres'në  
zëmër,  
Mbasi bota tash e tutje, me sy hapur sheh një ëndër;  
Sheh një ëndër me sy hapur,  
Gati nesër për t'a kapur,  
Nuk është ëndër; është një yll,  
Perse argu çel e mbyll;  
Yll i bukur yll i paqes,  
Si një vajz'e dashuruar,  
E pret'buz'e përvëluar,  
Që t'a puth në mes të faqes!

dëshpërim dhe shpresë

Edhe nëse po ajo të  
Edhe nëse në këtë orë  
Ajo muntajonadhe dorë  
Futuraj bërëb errenjë!  
Ajo nëse

Kombi i vafër Kombi i gjorë  
Si të jetë që përdorin kafshë  
Ajo pullëmb i bërëb bërë  
Kjo të jetë në të vjetër!

Re të kësaj gjë të dëshpërimi  
Kombeteroj të errëcira  
erëpi fuqia të jetë kësaj  
Në këllëq të errëcira!..

Kombi i vafër Kombi i gjorë  
Si të jetë që përdorin kafshë  
Ajo nëse bërëb bërëb  
Si të jetë në deg. të kësaj!

Faksimile e poezisë "Dëshpërim dhe Shpresë"

## **VLORA**

*Andej Qaf'e Topit hedhur si sorkadhe  
këtej Guzbabaja, një urat'e madhe,  
mu në mes të tyre shtrihet një qytet  
shtëpi e shqiponjës për eternitet;  
Vlora tungjatjeta, vëndi i mrekullive,  
maten me Sazanin degat e ullive!*

*Shëtita Evropën, shëtita Azinë,  
gjer'te moll'e kuqe, vajta gjer'në Kinë,  
sa tutje më tutje, sa lark e më shumë,  
dhe atje ku piqej buka mu në kumë;*

*deri prapa, diellit, në tingli majmum,  
dhe atje ku Zoti quhej Firaun!  
Tobe ja rabil fryhemi gjynah,  
kapërceva qiellin si një zok me krah!*

*Kapërceva dete mbushur me inxhira,  
kapërceva male gurë xhevahira,  
gjithë më gostitën, gjithë i gostita,  
sa më velesitën, sa u velesita!*

*Ç'do që desha pata, qumësht dallandyshe,  
sa të hanin gjithë, gjyshe dhe stërgjyshe;  
dhe me re të bardha dhashë edhe mora,  
hazinera gjeta, kur më hante dora!*

*Dhe me re të bardha mora edhe dhashë,  
po si Vlorën time një qytet nuk pashë!*

*Vlorën edhe Vlorën thelp e kam në zemër,  
ditën e kam dritë, natën e kam ëndër...  
çdo or'e minutë ty të kam në gojë,  
mbase të ze lemza, kur un'të kujtojë!  
Vlora im'e bukur, Vlora im'e lirë,  
vetëm ty të dua dhe një gun'të dhirë!*

*Aty n'ata rrethe, aty n'ato rrëza  
çdo zonj' e zonjushe matet me thëllëza!  
Aty shpirti dridhet, aty zemra hidhet,  
aty rreth e rrotull lozën gugulidhet;  
dhe për her'të parë po në atë vënd  
një zogëz, një... hajde, më rrëmbeu mënd!*

*Vlora im'e bukur, Vlora im'e lirë,  
vetëm ty të dua dhe një gun'të dhirë!  
E kudo që isha e ku do që jamte  
këng'në buz'të kishja, lot në sy të kamte!*

## **MIR'SE ARDHËT!**

*Mir'se ardhët burra trima,  
ju rrufera vetëtima.  
ju fytyra të florita.  
sy o sy me shtatë drita!*

*Dora juaj, ajo dorë  
kordh'e shkabës dykrenore,  
diti shkrepë shkrepëtiti,  
diti bukur e goditi  
pra, nga lind e perëndon  
nami juaj po gjëmon!*

*Që nga koh'e Kastriotit  
Nuk ish thën'nga an'e zotit  
të kish dalë edhe një bres,  
po kështu me këtë bes,  
dhe për shkabën dykrenorë,  
që të zinte qiell me dorë!*

*Ju u zutë, bres pas brezi  
dora juaj do ta ndezi,  
do ta bëjë flak'e zjarr  
gjithë kombin shqipëtar,  
do thot'burri më i lartë  
ah të isha i Vlonjatë!*

*Kështu thonë dhe do thonë,  
si rrufeja që qëllon  
edhe era suferinë  
që bën kuje ulërinë;*

*Edhe reja që rënkon,  
edhe pika që pikon,  
edhe bora aq e bardhë,  
edhe valët radhë radhë,  
edhe Hëna edhe Dielli,  
ç'ka në gji që i mban qielli.*

*Deshëm Vlorën, Vlora rroftë,  
me flamurin rroft'e qoftë  
Vlora jonë, Vlor'o Vlorë,  
Deh të lumtë ajo dorë!*

## **AH KY VËND...**

Ah ky vënd, ky vënd, ky vënd, që më bën e flas përçart',  
nënë qiej plot me yje, gjith'të art'e gjith'të zjarr',  
rreth me dete plot me vala, rreth me vala plot  
me shkumë,  
sa më afër aq më thellë, sa më lark edhe më shumë,  
rreth me kodra plot me pyje, rreth me male plot  
me borë,  
vënd'i burrave që lejnë me një çift rrufe në dorë,  
me një çift rrufe në dorë, me një teste zemra hekur,  
që për nderin e Atdheut u ka ënda për të vdekur!  
Vënd'i zonjave si lule, vënd'i luleve si zonja,  
vënd'i vajzave mes-holla, gushpullumbi syshqiponja!  
Gushpullumbi syshqiponja, këng'e shkrumave  
mbi valë,  
ku çdo vashëz i thot'hënës: A ti dil, a un'të dal!  
Pra, ky vënd do vej'përpara, dhe do vej'me vrap  
të plumbit,  
pasi neve dim'dhe ecim nëpër gjurmë të pullumbit!  
Edhe brenda pakëz kohë,  
dhe, makari, gryk'për grykë me rrufe, me er'me llohë,



do arrijm'atje në qiell, ku ka drit'e ku ka diell!  
Pra, me zemrën më të pastër dhe me bindjen  
më të thellë,  
me bes'burri armatosur si e ka për fis shqiptari,  
me një shpres'që s'ka të sosur dhe të gjith'si pika ari,  
musi eshtrat e një trupi, musi zoqt e njom'të zhgabës  
gjith'vëllezër, gjith'të dashur, gjith'të nënës,  
e gjith'të babës  
gjith'të babës, gjith'të nënës,  
dhe të gjith'si drit'e hënës,  
nëpër truaje tona derdhur, po këtu në këtë tokë,  
ku shqiptari, brez pas brezi, ka dhën'kok'e ka marr kokë.  
Na do rrojm'e do gëzojmë sa më mir'edhe më mirë.  
rroftë vëndi yn'i bukur, rroftë kombi yn'i lirë!

1924

~~Shkaba~~ - Shkaba  
kye kryepatur

Krist e Kris  
Thas e Thya

Takun ~~kalendari~~ sa qe fluturo  
Thas e Kris / Thas e Thya  
Kris e Thas . Kris e Kris  
Kris e Kris se pa Kris !

eta qe na jete odes  
eta qe shpirt e na qe gjat  
eta e barke gjatun flak !

• qe duni Babes na duni Babes .  
" duni e kushtin pakti Kris e Kris "

Esi : je je : vallaher  
Leken korbat opimluc  
Qe qe Kaba Kaba Kris  
do te thoset Kris heq !

At moj Shkaba e Kris  
Qand. erjend. e Thas flon  
me pacun do je Kris

do te Krisi Qand. L. Shkaba 1914

## **VAJZA SHQIPTARE**

I

*Kush të ka dërguar, hëna apo dielli?  
Pa më thuaj, të lutem, sa pate ka qielli?  
Nëpër ato pate, madhëri e artë,  
ka të tilla shtate, si të zotris'sate?*

*Në je nonjë ëngjëll, udhën ke lajthitur,  
apo sjell melhemin zëmrës së goditur?  
Në je nonjë valë, kush është' ai mall,  
që të ndez e derdhe e utrin'mbi zall?*

*Në je nonjë çupë, do të mbaj mbi sup,  
do të ngjesh në zemër, do të pi me kup'!  
Në je nonjë lule, e ku do keç mbirë,  
si mundet e bënet lulja kaq e mirë?*

*Në se je sorkadhe, lumthi kush ka çapa,  
lum ai q'i vete zotris'sate prapa!  
Kush të paska rritur, kush të ka selitur?  
Trupi yt i bukur si flori i situ!*

Në je nonjë xhinde, xhinde e arratisur,  
cilin ke vithisur, kujt i je kolisur?  
Ku është ai pyll, ku është ai mur  
ku ti vete fute dhe qëllon me gur?

||

Kush të ka dërguar, Hëna apo Djelli?  
Pa më thuaj, të lutem, sa yje ka qielli?  
Ka të tilla pyje nëpër ata yje?  
Ka të tilla xhinde nëpër ata pyje?

Qofshi të ergjënda, ka të tilla xhinde?  
Rrofsh e qofsh, sa malet, zotrote ku linde?  
Desha që ta dija ku është ylli yt,  
desha që ta dija ku është pylli yt!

Në je nonjë dritëz, dritëz perëndie,  
lum kush të ka afër, kurse nata bie;  
në je nonjë hije, hije hyjënore,  
kthema zemrën time, zemrën që ma more!

Në je nonjë erë, një veri në ver',  
nga se po të digjet trupi ylyver?  
Në je nonjë ëndër, shumë të lutem shumë,  
në të dasht'qejfi të të shoh në gjum'!

*Në je xhevahire, nga se nuk je dukur?  
Nga se xhevahiri rri në kuti futur?  
Në je nonjë flutur, kush të ka qëndisur?  
Kush është ajo dorë, që të ka stolisur?*

*Pa le ta dëgjojmë një herë e dy herë,  
fol, moj dallandyshe, që këndon mbi derë!  
Fol, moj dallandyshe, se sa më vjen mirë,  
mos je nonjë vajzë nga një vënd i lirë?*

*- Un'jam një arbreshe, rroj këtu në rrëza,  
një gjak e një gjuhë kemi me thëllëza;  
pullumb e sorkadhe jemi farë e fis,  
kemi dhe shqiponjën gjyshen e shtëpisë!*

*Çdo të mira kemi, dielli si ar  
derdhet përmbi neve nga çdo vend më par',  
lul'e vëndit tënë katër stina çel  
edhe erë e bukur na deh e na vell!*

*A e more vesh kush më ka qëndisur?  
është dritë e djellit që më ka stolisur,  
është dritë e djellit, është dritë e hënës,  
më shum'nga të gjitha është sisë e nënës!*

**Qershor, 1930**

D E K R E T

1. *Ali Asllani*

Me Keshilla e Naltë e Shtetit Shqiptar uardhrosim i caktuar  
mejm ty *Këshilltar në Kryeministri*

me një urrye të pashmëtytur...

Me prezantim të këtyre kushtetutëve të reja të shtetit shqiptar  
kështu të drejtë të ndërrimit të pastër të shtetit shqiptar  
të një ejet shqiptar.

Me detyrë të anëtarëve të shtetit të bashkëpunojnë  
përpara nesh!

Që data krye detyrën të ndërrimit të kushtetutëve të reja  
të shtetit shqiptar të bashkëpunojnë të bashkëpunojnë të bashkëpunojnë  
kështu të drejtë të ndërrimit të pastër të shtetit shqiptar  
të një ejet shqiptar të bashkëpunojnë të bashkëpunojnë të bashkëpunojnë

Tirane, 15.11.1920

KESHILLA E NALTË  
E SHTETIT SHQIPTAR

*Ali Asllani*  
*Ali Asllani*  
*Ali Asllani*  
*Ali Asllani*

Dekreti i Këshillit të Naltë të Shtetit Shqiptar për emërimin e Ali Asllanit si këshilltar në Kryeministri (1920)

## **MBANI KOKAT ATJE SIPËR KU MERR ZJARR E FLAK'RRUFEJA!**

*Kurse dimri bën të tijat, faq'e dheut ngelet keq,  
kurse dega, fleta thanen, ç'do gjë vuan e ç'do gje heq!  
Si një dorë, dor'e zotit, ajo dor'që s'ka të dukur,  
dalngadalë, nënë tokë, përgatit behar'e bukur,  
po ashtu dhe këtë ditë, ku gjith'bota u goditë  
dor'e bardh'e patriotve pa dyshim që përgatitë,  
përgatit një dit'të bukur, një të arthme më të pasur,  
ku do qesh'e do dëfrej'edhe zemra më e plasur!  
ku do qesh'e do dëfrej'ajo nënë dhe ajo...haj!  
ajo nuse shamizezë rreth govatës laj'e qaj',  
rreth gavatës laj'e qaj'me ca halle e plagosur,  
me ca halle, me ca burgje, me kurbete të flamosur!*

*Pra, të gjith'për njëri tjetrin, dhe me bindje të patundur  
rreth flamurit të pandarë, rreth Atdheut të pamundur,  
të patundur, të pamundur, as nga era as nga reja,  
mbani kokat atje sipër, ku merr zjarr e flak rrufeja!*

1935

## **7 PRILL 1939**

*Shtatë prill....  
Kopilove o kopil  
e u lute u këpute  
njëqind pash në dhe u fute!*

*Natyrisht një tradhëtor,  
spor e fisit arbëror,  
e pret hasmin me daulle,  
kur gjen ditën ta ben pulle!*

*Na e gjeti dhe na ra,  
vret Shqiponjën që s'u vra,  
nuk u vra dhe nuk do vritet  
posht përpjet me vrull vërvitet!*

*Ja dhe hymni që na thuri,  
hymn' i zi i një qivuri:  
"Eja eja alala  
të na rrojë Duçëja  
Duçëja guguçëja,*



*le të rroj'edhe flamuri  
sa për sy e për bela!"*

*I pabesi ta dij', pra,  
ndër kasolle me një tra,  
qe nga Shkodra gjer në Dropull  
rron ai që i thon' popull!*

*Ajo dor'që rreh dybekun  
di ta mbush edhe dyfekun,  
në se ditën çan ugar  
edhe natën thur litar,  
thur litar e kalit grushtin  
dhe e var nga këmbët pushtin!*

## **DASMA E MADHE**

*Un'të them se jam i kuq, ti më thua jam i bardhë,  
un'me huq e ti me huq, pra... të zezat radhë radhë!  
Nën'e zezë, motër e zezë, bab'i zi e babëzi,  
na një çap - një varrezë, ky atdheu yn'i zi.  
Ky atdheu yn'i zi na u bë skëterr i vrerit,  
varen eshtrat e shqiptarit nëpër sqepe të sqifterit.*

*Dhëmb për dhëmb e sy për sy, si ti mua dhe un'ty!  
Nëna ime nëna jote zën'e qajnë për të dy.  
Djali babën, baba djalin vuan ta zër'e ta përzërë,  
që ta pjek në hell të gjallë, t'i pres'mishin me gërshërë.  
Bot'e çmendur, djall i çmendur, zot i çmendur, gjith'të  
çmendur,  
vetëm vdekja bën të sajat, ha e ha e s'ka të dendur.*

*Perëndi, o perëndi!  
Bota thot se ti kur dashke, bën si do e bën si di.  
Shënjtërin'e vendit tonë nuk e ka edhe një tjetër.  
Është këtu Baba Tomori- kryefron i yt i vjetër,  
jemi rob'taban i tija, varfanjak'edhe dervisha,  
jemi rob'kurban i tija me xhamia dhe me kisha.*

*E pra ti, o perëndi, pse na le në dorë të djallit,  
që na shtypi, na përtypi nëpër nofulla të çakallit?*

*Po tani u bë ç'u bë, ti o zot i këtij dheu,  
s'mund të bësh asgjë, t'i thuash kohës: prapa ktheu!  
edhe rri e bën sehir, bën sikur asgjë nuk di,  
pra dhe neve jemi kundra, duam një tjetër perendi!  
Duam një zot që do të mund të na kap'e të na tund,  
të na tund e të na shkund, vëllavrasjes t'i jap' fund.*

*Perendi, o perendi, vi përpara zotris'sate  
duke pasur përmbi supe një vandak të rënd' mëkate,  
po mëshira hyjnore është'e thell'e është'e gjerë  
më e thellë nga gjith'mëkatet që ka vendi yn'i tërë.*

*Po më fal*

*për këto fjal',*

*që guxova dhe i thashë, i rrëmbyer edhe i trembur,  
mbasi gjuha më rreh dhëmbin, atë dhëmb që më ka  
dhëmbur.*

.....  
*Më rrëmben edhe më nxitë, kurse shihen ca jezitë,  
dikur'mburen me evgjitë, dikur tallen me profitë,  
për të ligun flasin mirë, për të mirin flasin keq,  
gjuh'e tyrejt gjarpër fshihet, kombi varfër vuan e heq.*

*S'kemi fjalë për ca kusarë, vith e ha vith e ha,  
me një bark sa dy hambar',ata leri mos i nga.*

Ali Asllani

---

*Ata kanë një vulë në ballë,  
dhe njëqind e një dhëmballë.*

*Dhe njëqind e një dhëmballë, çdo dhëmball' me  
shtatë presa,  
Mir'po kombi ka të tijat, një milion e gjysëm pjesa.*

.....  
*Vendi ynë që ka jetuar herë me pushkë e her me shat,  
s'mund të lihet tash e tutje si një flet'në degë të that',  
ai lipset që të rrojë, qoft, me hir'e qoft' pa hirë,  
dhe aty ku bie zjarri, bëhet luljt më e mirë.*

## **ALI PASHA TEPELENA**

*Nga satrapët më satrap  
nga dervishët më dervish,  
ky zabit, ky dreqo - lab,  
pa kalem e pa qitap,  
paskish lindur me këmish!*

*Po satrapin, unë ju lus,  
mos ta marrim për qortim,  
ai ish një kryetrim,  
një rrufe një vetëtim,  
që i tha sulltanit; sus!*

*Një rrufe.....  
Po rrufeja, vini re,  
i ka rrënjët në një re!  
si dhe truri, tungjatjeta,  
me gjith'dritëzat e veta,  
i ka rrënjët në kaptinë!  
po sa larg dhe se sa lart  
shkon e ndrin e vetëtin'!*

*Dhe Ali Pasha kajmeni  
njp stërnipi i një dere,  
soj dervishi, soj sejmeni,  
i ushqyer me mëna ferre!*

*Me guximin mrekulli  
u bë kryefermanlli,  
dhe nga truall i tij i ngusht'  
i lëshoi një goxha grusht  
perandorve osmanlli!*

*Dhe arriti sa, pothuaj,  
në tryeza të çezarve  
ku vlon hymni ngadhënjimtarve,  
hymn'i tija s'mbet i huaj!*

*Le t'i ngrëm', pra, një doll!  
Fam' e tija më e madhe!  
Në e ultë historia,  
di ta ngrerë Shqipëria,  
sepse trimin, nuk e nuk,  
trimi trimin nuk e zhduk!*

### Vërtetimin

Më rastin e ngjarjes në 31 Mars (grusht shteti) 1908 në Gurgji, Tamarit Demaliti për arsye të vëprimit të tij në patriot shqiptar nga ana e Gurgje të Rinj u konsiderua në mënyrë të kaligjërshli dhe u akuzua si reaktionar (Myzeleabi) Në Jaminë dësa oficeri të deleguar nga Komanda Ushtrisë e Jaminës erdhën në klubin "Bashkimi" të shqipëtarëve dhe para qitë anëtarëve, mbajtën një fjalim kundër Tamarit duke përsëritur këto akuzat. Majori shandër, marrosi Sija Berasca, gj. ish anëtar i këtij klubi dhe Ali Dollani anëtar po i këtij klubi u përgjigjën duke kundërshtar liberalizimin e Tamarit Demaliti dhe i refuzuan akuzat e tyre. Më tej, për pak kohë Memushia e Prandishomë Gurgje urdhëroi tëqgrafidit intermisionit e ketyre të dyve, Sija Berasca për me Selamit në formë dispozicioni dhe Ali Dollani për me Halop (Sijri) si bashkëpunëtor të Tamarit Demaliti. Ali Dollani me një mënyrë kaloi Karfuzi. Uloni dhe me vone, sube u shënuar se delegat i këtij klubi për me Kongresin e Dibris, shkoi në Tisbeu rite kësaj shpëtimi.

Musa Demiri  
 (Për Kom. Ekr. H.P. Laçi e Vërtetimit fjalor  
 (Nga Leskoviku)  
 i nënprefekt i gjendur të gjykatës  
 Jaminë në atë kohë.

Vërtetimet jina me  
 Liront në 8.11.08



Deklaratë e Nezir Leskovikut dhe Musa Demit për ngjarjet e vitit 1908 në Jaminë.

## **FSHATI DHE PERLATI**

*Gjysëm shekulli më parë, më tej bregut Allatojt,  
kurse nise për në Pllaçë, në të djathtë rrëz'përroit,  
ka pas'qen'një shpell'e madhe,  
përmbi sup të saj Beuni rreth me pyje plot sorkadhe!*

*Shpella quhej Shpell'ë Bletës, me një maj'si  
thik'e prehur,  
ledhe-ledhe hoje mjalti kish në gji të saja fshehur,  
Ledhe-ledhe hoje mjalti, sepse bletët me kopera,  
që prej kohve shumë të lashta, hynin, dilnin kurdohera!*

*Fshat, o fshati im i bukur, fshati Vajzë hane-hane,  
fshat që s'paska një të dytë në këtë mavri jallane!*

*Që prej gropave Maraqthit gjer në maj' të Velesanit  
tingëllonte këngë e ziles, edhe këngë e jataganit!  
Dhe një mijë e ca dybek'bam e bum ne der'të stanit...  
Në një dit'në Muço Mato mijra dele pinin ujë,  
ku dhe delja tet'vjeçare bënej zog'e bënej ftujë!*



*Këmbëkryqë, nënë rrepe, kuvëndonin ca nishan  
dëgjon Rrëza dhe Shullëri me sa thanë e se si than'!  
Valleve në lëm të Leçe, xhan o xhan, në atë lëm,  
u përgjegj këng'e lashtë, që nga vështi Rrotullëm.*

*Fshat, o fshat i gjyshit tim, fshati Vajzë hane-hane  
fshat që s'paske një të dytë në këtë mavri jallane  
Gjysëm shekulli më von'vajta pyeta ku është' fshati,  
ku është'Çeçua, ku është'Xhaj', ku është'shpella,  
ku është'mjalti?*

*Po kur pyeta për të riun... e ku është'sorkadh Perlati?  
m'u përgjigj një botë e gjith'dhe një varr nga Rozafati:  
Sa do van, po këtu janë, do t'i kini përsëri  
edhe fshatin edhe bletën, edhe mjaltin ngjyr'flori.*

*Dhe mbi sup të Allatojtë, në atë të shkret'bregore,  
ja, mu aq sa Shpell'e Bletës, një Shqiponj',  
një permendore,  
përmendorja e Perlatit, brez pas brezi do na flas'  
për të vdekurin që s'vdes edhe qindra vjetë pas!*

## **PERLAT REXHEPI**

*Pyeta Labërinë:*

- E ku është Perlati?
- Ish një suferinë  
edhe shkoi e vajti.

*Pyeta Shqipërinë:*

- E ku është Perlati?
- Kombi ulërinë  
më shum'nga i ati.

*Pyeta djalërinë:*

- Ç'e bët'shokun, mikun?
- Jet' për Shqipërinë,  
vdekje për armikun!

*Tani, ti dhe unë,  
gjith'e dim' Perlatin,  
djepe kish Beunë,  
varr ka Rozafatin.*

*Historia thotë,  
kryetrim i ri,  
një tufan me lotë  
një flamur flori.*

## **NJË FLAMË**

**(Një spiuni)**

*Ësht'një flamë, zot o zot,  
flam'e madhe, flam'e ligë,  
zemra sterr e shpirti shtrigë.*

*Njerëzia deri sot  
s'kishte par'të till'njeri,  
pa mëshir', pa vetëdi.*

*Ky nuk paska shok në botë,  
aq i poshtër, aq i ndyrë,  
i pabes'e i palyrë!*

*Të bën keq, se është i lik,  
jo për ty që s'të ka mik,  
po për ty e për të tjerë,  
është'një gjarpër me dy krerë!*

*Ësht'një gjarpër mbi gjarpenjë,  
gjuhë e tija helm e vrerë,  
punë e tija lenjë e tenjë!*

*Mos ja zini emrin ngojë,  
edhe emri të kafshon,  
të shajton e të helmon!*

**1917**

## **QEVERIA ËSHT'E PASHËS...**

*Koha jon', mor mik i dashur, ishte thurrur  
prej mëndafshi!  
Më lejoni t'ju qaj hallin dhe një herë, ashtu më qafshi,  
Nuk kalonte as një ditë, pa u par'një madhështi,  
madhështi e një vatani, si e donim un' dhe ti.*

*Ja, për shëmbëll, flet kasneci, dhe kasneci  
do me thënë,  
ishte gojë e qeverisë, ish gazetë e vendit tënë,  
pa dagjoni, thot'kasneci, ju mileti arnaut,  
ju mehmurë e ju esnafë, gjith' ju populli harbut,*

*mos i çani kryet pashës duke fol' për qeveri,  
qeveria është e pashës, bën si do e bën si di,  
edhe Pasha e di mirë ç'do me thën'politikë...  
shtatë kralet e kan' mik, edhe mikun më besnik!*

*Dhe kështu i gjith' mileti rrinte sus! dhe sa për na  
ngriheshin të gjith' në këmbë dhe na bënin temena!  
Tani lumi që na mori, na gënjeu kjo jallane...  
Vate jeta hanedane, jeta jonë hane-hane,  
e u prish dynja e shkretë, për oxhakët s'mbeti vënd...  
pasi labi veshi çizme edhe gega vuri mënd.*

## **JA PROGRAMI IM ËSHTË KY**

*Tani ndodhem në një moshë,  
gjashtëdhjetë e disa vjeç  
dhe si ju po hiqem osh  
jam tamam për deputet...*

*Ja programi im është ky:  
Do përpiqem për një hua,  
dy të tretat janë për ty  
dhe kusuri është për mua!*

*Më ke mik e të kam ton,  
bota mbjellën, ne e vjelëm,  
Shqipëria është një lopë,  
rrofshim ne që dimë e mjelëm!*



# Kryesia e Republikës Shqiptare

Nr. 65



## Zogu

Kryetari i Republikës Shqiptare  
I mveshun prej vullndetit të Popullit  
me fuqinat sovranë të Shtetit

### Dekreton

emërimin e Zotri *Ali Asllani*  
i Ngarkuom me Punë i Legatës  
sone në Sofie -

Ret prej tij besnikëri, zell në detyrë dhe shër-  
himë të drejta me udhëgjyqje të pastër e kombëtare.

Tirana, më 16. Qershor 1928.

Zot. Ministri i P. të Jashtme

*H. Haxhi*



*Haxhi*

Dekrete mbretëror për emërimin e Ali Asllanit "I ngarkur me punë"  
në Sofie.

## **DËSHIRA E LABIT**

*Sikurse kismet  
të më pyeste mua:  
ti, o bir, çfar' do?  
Ku di unë i shkreti,  
çfar't'i thoshja dua,  
po që, domosdo,  
do i kisha thënë  
një kope me dhënë  
që të rroj me to!*

\* \* \*

*Dua dhe një stan,  
rreth lajthi e than' ,  
afër një përrua,  
më afër një krua,  
dhe një pyll i lirë,  
e një spat' të mirë!*

\* \* \*

*Dua dhe një ftujë,  
nuse... gugufu,  
ajo të mbarë ujë  
edhe të bëj' dru,  
quati dhe unë  
ta pështjell me gunë  
dhe ta mbaj mbi gju.*

\* \* \*

*E kush është'më mirë  
nga një jet'e lirë,  
dhe asgjë mbi krye,  
vetëm... qiell me yje!*

## **OKUPATORËVE**

*Aty, ndal!*

*Gjalmëzeza ka bër' djal',  
djal'fajkua, djal'sqifter,  
pra, në vetull gjak të merr;  
djal' fajkua, djal'fatos,  
aty ngul dhe aty sos!*

*Ti ku vete? Ku po vete?  
Frëng, o frëng, që s'je në vete!  
Këtu furka e një stani  
ka dy presa jatagani;  
nënë këmbë të një dhije  
zhduket gjurm'e një hordhije!*

*Aty ndal, sepse këtu,  
si çdo gur'e si çdo dru,  
bëjnë goj'e bëjnë dhëmbë,  
duf i tyre djeg e shëmbë!*

*Druri, eshtra e një dreri,  
të një pulsi, të një zëri,  
përmbi dega shkrifet sqifi,  
nënë dega shtrihet difi!*

*Guri, gur'i një qivuri,  
rrëfen varrin e një burri,  
të një burri, burr' me besë,  
që ka ditur si të vdesë!*

*Shtrydhe tokën, kullon gjak,  
në një çap e dy bonjakë,  
s'hahet hak'e këtij gjaku,  
s'tretet lot'e një bonjaku!*

*Të bonjakut pa këmishë,  
gjith'kokalla të pamishë,  
më i lumturi si plis  
kalipeç mbi një kurris.*

*Këta ripen, po do rriten,  
për Atdheun din'e vriten,  
din'e vriten, din'e vrasën,  
din'armikun ta përplasën.  
Ti ku vete? Ku po vete?  
Frëng, o frëng, që s'je në vete!*

## **HAKËRRIM**

### **Hani, pini dhe rrëmbeni!**

*Që nga Korça gjer te Shkodra mbretëron një errësirë,  
nëpër fusha, nëpër kodra, vërshëllin një egërsirë!  
Pra, o burra, hani, pini, pini or'e çast,  
për çakallin, nat'e errët, është ras'e deli ras'!*

*Hani pini dhe rrëmbeni, mbushni xhepe, mbushni arka,  
të pabrek' ju gjeti dreka, milioner'ju gjeti darka!  
Hani, pimi e rrëmbeni, mbushni arka, mbushni xhepe,  
gjersa populli bujar t'ju përgjigjet: peqe, lepe!*

*Ai rron për zotrin tuaj, pun'e tia, djers'e ballit,  
është'kafshit për gojën tuaj. Rroftë goja e çakallit!  
Shyqyr zotit, s'ka më mirë, lumturi dhe bukuri,  
dhe kur vjen e ju qan hallin, varni buz'edhe turi!*

*Hani, pini dhe rrëmbeni, është koha e çakejvet;  
hani, pini e rrëmbeni, është bot'e maskarenjvet!  
Hani, pini, vidhni, mblidhni gjith'aksione, monopole,  
ekselenca dhe shkëlqesa, tutti quanti come vuole!*

Nënshkrim'i zotris suaj nëpër banka vlen milion,  
ju shkëlqen në kraharuar dekorata "Grand Cordon"  
Dhe kërkoni me ballhapur (!) komb i varfër t'ju thërres'  
gjith'me emrin tingëllonjës: Ekselenca e shkëlqes'  
dhe të quheni përhera luftëtar'e patriot',  
në ka zot dhe do duroj', posht ky zot, ky palo zot!

Grand Cordon i zotris'sate, që në gji të kan'vendosur,  
është'pështyma e gjakosur e atdheut të veremosur;  
dhe kolltuku ku ke hipur, duke hequr nderin zvarr',  
është' trikëmbshi që përdita varet kombi në litar!  
Dhe zotrote kurulldise, diç u bëre e pandeh,  
kundër burrit të vërtetë zë e vjell e zë e leh!

E na tunde, na lëkunde, nëpër salla shkon e shkunde,  
mbasi dora e armikut ty me shok'të heq për hunde.  
Rroftë miku yt i huaj, që për dita los e qesh,  
të gradoi katër shkallë, pse i the dy fjal'në vesh!

Koha dridhet e përdridhet, do vij'dita që do zgjidhet  
dhe nga trasta pem'e kalbur doemos që jasht'do hidhet!  
Koha dridhet e përdridhet, prej gradimit katër shkallë  
nuk do mbetet gjë në dorë veçse vul'e zez'në ballë!

*Mirpo ju që s'keni patur as nevoj'as gjë të keqe,  
më përpara nga të gjithë, ju i that'armikut: "Peqe!"  
Që të zinit një kolltuk, aq u ulët u përkulët,  
sa në pragun e armikut vajtët si kopil u ngulët!  
As ju hahet, as ju pihet, vetëm titulli ju kihet...  
Teksa fshat'i varfër digjet... kryekurva nis e krihet!*

*Sidomos ju dredharakë, ju me zemra aq të nxira,  
ju dinakë, ju shushunja, ju gjahtar'në errësira!  
Ç'na pa syri, ç'na pa syri!...Hunda juaj ku nuk hyri:  
te i miri, te i ligu, te spiuni më i ndyri!*

*Dallavera nëpër zyra, dallavera në pazar,  
dallavera me të huaj, dallavera me shqiptar'  
Vetëm vetëm dallavera, dhe në dëm të këtij vëndi  
që ju rriti, që ju ngriti, që ju ngopi, që ju dëndi!*

*Në se kombi vete mbarë, nesër ju veproni ndryshe,  
dylli bënet si ta duash, kukuvajk'dhe dallandyshe...  
kukuvajka gjith'me lajka, nesër silleni bujar,  
nënë dorë e nënë maska, shkoni jepni një kapar!*

*Dhe kujtoni tash e tutje me të tilla dallavera  
kukuvajka do përtypi zog e zoga si përpara...  
Ja, ja, grushti do të bjeri përmbi krye të zuzarve,  
koha është e maskarenjve, po Atdheu i shqiptarve!*



*Edhe ju të robëruar, rob në dor'të metelikut,  
fshini sofrat e kujtudoj'puthni këmbën e armikut!  
Që ta kesh armikun mik e pandehni mënçuri,  
mjafton bërja pasanik, pasanik dhe bej i ri,  
dhe u bëtë pasanikë, me pallate, me vetura,  
kurse burrat më fisnikë japin shpirtin në tortura!*

*Vëndi qënka sofr'e qorrit, vlen për goj'e për lëfytë,  
bëni sikur veni vetull', shoku shokut kreni sytë...  
Dhe për një kërkoni pesë, po më mir'njëzet e pesë.  
Le të rrojë bataçiu dhe i miri le të vdesë!*

*Po një dit'që nis e vrëret do mbaroj' me burbullimë,  
ky i sotmi, zër'i errët, nesër, bënet vetëtimë  
dhe i bije rrufeja pasuris'dhe, kësilloj,  
nuk ju mbetet gjë në dorë, vetëm një kafshit'për goj'!*

*A e dini që fitimi brënda katër vjet mizor'  
nuk është'yt, nuk është'imi, është i kombit arbëror,  
është'i syrit në lot mekur, është'i vëndit djegur pjekur.  
Ju do thoni si të doni... po e drejta dërmon hekur!*

1942



*Ali Asllani në Sofje (1930)*

## **KOKA BËN E KOKA VUAN**

*Njëher'varet trikollori, herën tjetër kryq' i thyer...  
paska rar'hallva nga qielli e ja nis'një dallaver,  
mbushen xhepet me flori  
e qinosen ujk e dele për të bër' një stan të ri!*

*Shitet vëndi për para, me para e për para  
bënet burri telendi, dy para një maskara,  
para hasmit peqe-lepe  
para zërit të atdheut hund' e tyre shtatë sqepe!*

*Duke bler' e shitur erë dikush bënet milioner,  
kurse shoku pinte uthull lum zotria pinte verë...  
Milioneri yn'i ri  
para shokut të dikurshëm vari buz' edhe turi!*

*E përhera me dy faqe, që të haj'e që të bluaj',  
në një kohë mbi dy frona, në një çast e mbi dy kuaj,  
me dy faqe, me dy nofla, në një xhep e dy flamur  
e hedh këmbën me daulle edhe turk edhe kuar!*

Na të urt' e të mëndafshtë s'qem' të zot të bënim zë,  
kur fillon me thash' e theme hij' e vetes të përze;  
neve ndryshe, puna ndryshe, defi ndryshe  
kënga ndryshe,  
e ç'kërkon në gji të gjëmbit të këndoj' një dallandyshe?

Mirpo vendi paskish zemër, paskish sy e paskish vesh,  
shikon lark e dëgjon thellë, di të vesh' edhe të zvesh',  
tani eja e t'ja themi asaj kënge që ja thonë:  
Koka bën e koka vuan, ç'ke moj zemër që rënkon!

## OUR | Le départ de M. Ali Asllani

projet de  
statif

Washington

ite, doyen de  
le des affaires  
au sénateur  
mbres du Sé-  
bliquement à  
Etats-Unis au  
ultatif qu'on  
Londres. Il a  
ix trop élevé  
naval des cinq

silence com-

nande

chargé de  
u cabinet

ophie de Ber-

a chargé le  
entre, de for-  
t faisant en-  
la situation



M. Ali Asllani, ministre résident d'Albanie en notre ville, vient d'être appelé au poste de ministre plénipotentiaire d'Albanie à Athènes. M. Ali Asllani, né à Valona en 1884, fit ses études au gymnase de Janina et les acheva à l'école «civile impériale de Turquie», dite «Moukhié». Il prit ensuite au service dans

## **IMAM EFENDIU**

*Na, mor mik i dashur, kemi një Imam,  
sikurse një veshje rreth e rrotull dhjam,  
rrethuar me shokë, me bij e me bija,  
gjith' qyteti ynë është' shtëpi e tija;  
një baba për popull, një baba fëmije,  
një uratë e madhe, njeri perëndije!*

*Kur që e thërresin këtu e aty,  
efendiu yn' fjalën s'ta bën dy,  
në dasmë e në valle, nëpër zifafete,  
lugën nënë mëngë, ai vjen e vete!*

*Plasi një dit'pushka, populli në sulm...  
Eja - i thon'shokët - lufta është'në kulm! -  
Mirpo efendiu qënka lodhur tepër,  
un'- thot - kurdohera, s'paska njeri tjetër? -*

*Eja, efendi, paşi kemi dasëm,  
eja, efendi, ham e pimë e flasëm!  
Eja, efendi, sonte kemi valle,  
Eja, efendi, se do qajmë halle!*

*Eja efendi, kemi sihariq,  
Eja t'i ham' hallvën, pasi vjehrra vdiq! -  
Erdhën dallandyshtet, tani vjen lejleku,  
sosi revania, ja po vjen byreku,*

*Eja m'u bëj kumtër, vajzën time qethe,  
eja, efendi, e më ysht për ethe,  
eja, efendi, eja efendi...  
- Tani u bë tepër dhe, për perëndi,*

*më ka plasur buza duke qënë i pari,  
mirpo me një lule s'mund të vij' behari!  
Tashti për në luftë radha është e juaj,  
pasi qënka thënë, un' do rri të vuaj!*

## **KOHA JONË, I DASHUR MIK...**

*Koha jonë, i dashur mik, ishte thurrur prej mëndafshi,  
më lejoni t'ju qaj hallin, përsëri ashtu më qafshi!  
Mund të bëje çfarë të doje, vetëm vetëm jo gjynah,  
mund të merrje katër femra, po që duhej më nigjah!  
Rahmet paçin ata burra, më të mirët paskan vdekur,  
po i miri rron përhera, e vërteta dërmon hekur!*

*Neve kishim në mëhallë efendin', një xhevahir,  
nuk ma bënte fjalën dy, më përgjigjej: me hair!  
Me hair këtë martesë, me hair atë kamatë.  
me hair, me këmb'të mbarë dhe këtu më paç uratë!*

*Vure dorën përmbi zemër, për dy një dhe jo  
më shumë,  
më mir' pak edhe me hakë, sesa shumë edhe  
për lumë!*

*Ma qëndiste mir' senetin, sipas ligjit të dovetit  
që të ruhej haka ime, edhe haka e miletit!*



*Si njeri i perëndisë, me qitap e me nigjah,  
ja kish qejfi të martohet her'pas here me një femër,  
thosh për priftin e mëhallës: prift'i gjor'allah, allah,  
nuk martohet dhe, prandaja, shih me sy e plas  
me zemër!*

*Një dit'prifti iu përgjegj: Pa dëgjo, mor efendi,  
nuk ta kam zilin aspak, se për Krisht, për perëndi,  
më mir'një e nënë dorë  
se sa katër me kurorë!*

## **NASTRADINI - MUSOLINI**

*Dikur Nastradini mbante në kafas  
një siqok', të cilën ai e liroi  
dhe i vajti pas...*

*Ga-ga-ga siqoka, shkoi e qëndroi  
në bri të një kau...*

*"Hë - thot'Nastradini, - lavdi past'allahu,  
ngjau se si ngjau, u bë imi kau!*

*E zaptoi siqoka, çupa e dashur ime,  
me rrezik të jetës, sa shpëtoi në qime!*

*Tani këtë ka, s'e lëshoj nga dora  
që me kaq mundime munda dhe e mora!"*

*Tani ju e dini,  
dikur Musolini*

*lëshoi ca siqoka nëpër dega lisi,  
ku ja thon'shqiponjat këngës së një fisi.*

*"Tani - tha - Ballkani, pronë e Perandorit,  
tej për tej shqiptarët rrotull trikolorit  
me një fat të ri, me një fe të re."*

*Me një fat të ri, në se i vë re,  
qënka mos na qënka, një përrallë e re!*

## **NASTRADINI U BË SARAF**

*Dikur Nastradini shtrohet në pazar,  
duke thyer t'holla, bënte tregëti,  
me një cop'flori vjen një katundar  
e i thot': ma thyej, florin efendi!*

*Me të marr floririn në dor'Nastradini,  
i thot katundarit: duhet që ta dini,  
ky flori, mor mik, nuk peshon tamëm!  
- Mir'- thot katundari - zëre sa të zëm',*

*e më jep kusurin se do shkoj në punë!  
- Jo - thot Nastradini, - nuk të lejoj unë!  
Mua ti akoma nëm edhe diçka  
pse ky është'eksiq! edhe pa shaka*

*dua yst akoma, un' për perëndi  
jam njeri allahu, dallavera s'di!  
Me që është'eksiq, për ta bër'tamëm,  
nëm dhe pak të holla, llafet le t'i lëm' ,*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*tani ne mos munde që të më paguash,  
eja n'arën time, e ashtu, më ruash,  
eja disa ditë më punë në arë  
pasi ligji thotë: borxhi duhet larë!*

## ***U BETOVA NJË DITË RËNDË...***

*U betova një dit'rëndë, mora një vendim të prerë,  
një her'vdes njeriu i shkret, sikurse një her'ka lerë.  
Tash e tutje s'do pi kurrë, nuk do pi raki aspak,  
ndryshe unë s'do jem burrë, po do jem një burracak!*

*Edhe dola për shetitje poshtë e lart në shetitore.  
Mbledhur shokët rreth tryezës duke pir'në pijetore...  
Të kam gjetur, më ke gjetur, dy meze e një raki,  
një raki për shtatë qejfe të jep rrushi razaki!*

*Mirpo unë goxha burrë i betuar e i vendosur  
s'mund të hyja dhe nuk hyra në pijetore të flamosur:  
I ka hije detit vala, i ka hije kalit shala,  
po më shumë nga të gjitha, i ka hije burrit fjala!*

*Dhe vazhdova në shetitje.  
Shokët pyesnin me habitje:  
Si, qejfliu i rakisë sonte mbeti pa një kupë?  
Dukej kupa, vente, vinte si një zogëz me kaçup'!*

Un' aty dhe përsërisja benë e bërë një me dy,  
sa u dëndësua nata, errësira gjith' në sy. -  
S'ish më koha për shetitje.  
nëpër gojë e nëpër buzë nisi dhe një far' lepitje.

Ah kjo kupëza çapkëne, ta marr dreqi e ta hajë!  
si një çup'më shkelte syrin, si një çup'për kok'të saj,  
Mirpo un'e mbajta veten si njeriu i betuar,  
s'mund të hyja dhe nuk hyra në pijetoren e shajtuar.

Burr, o burr, që u tregova jo më pak nga dy tri orë!  
Me që mbeta i kënaqur për qëndrimin tim burrnor.  
e vendosa atë ças  
me dy gota raki rrushi veten time të qeras...  
Bravo, thash'e meritova!  
Hyra brënda rreth me shokë  
për shëndetin timë të vlefshëm piva po thuaj një okë!

## **XHAXHO**

*Xhaxho! më thot'tjetri, prit që të vij'radha!  
- Unë aga i vjetër dhe me flok'të bardha?  
- Gjith'nderimet tona për flokët e bardha,  
sa për radhën, xhaxho, radha duhet mbajtur!  
- Katër pash'më hapej porta ku kam vajtur!  
sepse jam i njojhur-o den-baba-den,  
- Lini - fjalën xhaxho, s'para më pëlqen!*

*Jo e jo u nis, jo e jo u sos,  
ah, mor tungjatjeta, bota u çkallos!  
Qoft'dhe Hanko halla duhet që të presë,  
kjo e shkret'jallane qënka e pabesë!*

*Humbi agallëku, s'mbeti më taraf,  
u leksëm u plëksëm e u bëm'tuhaf!  
Një puntor i thjeshtë, djalli që na polli  
vjen e kurulldiset si një bej Stambolli!*

*Humbi agallëku, humbi tevabija,  
nuk na varën torbën këto bir'e bija!*

*këto bir'e bija, si lum e përrua  
me një cfurk në dorë, që i thon'pirua,  
për tre vet në sofër shtrojnë dyzet qelqe  
han'dhe veç e veç si pa gjë të keqe!*

*Nëpër vëndet tona, dikur Hysejn Nona  
s'mundi që të gjente çorbë me limona!  
Tash në vënd të dhallës, plasi pij'e birrës,  
piqet për meze në hell keci pirës!*

*Mua sidomos, në ka gjetur hall,  
plaka ime vuri dhëmbë e dhëmball',  
ja kurdisi djali dhe ma bëri ftujë,  
mir'po që at-here jemi bër'rrëmujë!*

*Më është bër' qibare! Ja se ç'më ka gjarë,  
një nat'më pat ftuar miku im fshatar  
dhe unë i thash plakës: e ku je, moj grua,  
dhëmbët që i vuri m'i jep sonte hua,  
mi jep sa për sonte që të ha kollaj!*

*Plaka m'u përgjigj: ujku të të haj!  
jo që nuk m'i dha po dhe më përqeshi!  
Edh un'ja bëra si e bën arbreshi,  
e zura për fyti, e plasa për sheshi!*



## **QË KURSE U PRISH DYNJAJA...**

*Që kurse u prish dynjaja  
i paudhi gjeti shtek,  
pa bër'dasma dhe duaja  
futet dhëndri në gjerdhek!*

*Ti haj' ujku hoxhë e prift,  
na jan'bërë mish e thua,  
lan'rininë e bënen çift  
me një fjal': më do të dua  
dhe kapar një puthje hua!*

*Edhe femra, për së prapthi,  
paska luajtur nga fiqiri,  
më par'fshihej gjer te lakthi,  
sot të vret me bomba gjiri!*

*Gratë i thirri hyqymeti  
që të shkruajnë në maqinë,  
zotërinjtë, lumi deti,  
kruajnë magjet në guzhinë!*

Ali Asllani

---

*S'mbeti mjekër e mustaqe  
që t'i thotë gruas: sus!  
dhe në hedhtë mjell në faqe,  
ta mbërthejta hedh'në pus.*

## ZONJA LU

- Motiv Kinez -

*Një dit'dola për shëtitje,  
afër udhës, në varreza, pash'një zonj'me shumë habitje  
veshur krejt me rrob' të bardha duk' i bër'  
veri një varri!*

*Që t'i bësh' veri një varri është punë e një të marri.  
lu afrova... një flori, mrekulli një bukuri...  
dorë e saja vinte vinte, bën veri e bën veri!*

*E un' tepër i çuditur i them zonjës të më falë  
dhe si gjysëm ngushëllimi pëshpërta dy-tri fjalë,  
dhe iu luta të më thoshte i kujt është ky varri i ri,  
varr i freskët e i njomë, e përse i bën veri.  
Zonja kuqet e stërkuqet, bën të thotë e nuk më thot',  
nuk më thotë asnjë përgjegje, lutja ime vajti kot!*

*Rrobë e bardh' që kishte veshur, më tregoi  
se mbante zi,  
sa do heshti buzë e kuqe, foli syri i saj i zi!*

*Lem të lutem...dhe vazhdoi, përsëri e përsëri;  
dorë e saj s'kish të lodhur, bën veri e bën veri!*

*Nuk më ikej nga merak, po kur shoh se aty afër  
po ma bën me dor' një grua, ajo ish një plakë e varfër,  
më thotë: eja, e di unë, ta rrëfej se ç'janë ata,  
atë varr e atë grua, në më jep disa para!  
edhe un', mor zotëri, me këto parat e tua  
shkoj e blej një nusk' nga prifti të më zgjatet jeta mua,  
pse në vëndin ton' të dashur me fuqirin e floringje  
edhe jeta blihet, shitet, rroft' magji e priftërinjve!*

*Tash, ajo që pyetni ju  
është zonjë e një poeti edhe quhet zonja Lu;  
Varri është i të shoqit, ish poet i madh i vëndit,  
që peshohej këngë e tija me derheme të ergjëndit!  
Burrë e grua, mish e thua, çift i ëmbël, çift me shije,  
çift, o çift, që s'ka të dytë, si dy kokërrza qershije!*

*Një dit'burri u sëmur, dy plevita në një vënd,  
një sëmundje shumë e rëndë, zonja Lu u prish  
nga mend!*

Thirr e çirr e laj e qaj,  
dhe i thot'burrit të saj:

Në se mbyllen syt e tu, unë veten do ta vras,  
dhe bëj be, që atë ças më ke pranë e më ke pas;  
ti ma bëre shtatin tim kryefron të dashurisë  
dhe un'varrin do ta bëj' shtratin tim të nusërisë!

- Jo, të lutem, - i thot'burri, - shumë të lutem,  
mos bëj be!  
- Mirë, at'herë un'do mbetem gjithë jetën një e ve!  
- Jo të lutem, Luja ime, mos e bëj dhe këtë be!  
- Si, pra, unë do duroj'në më zënt kjo rrebe?  
Pra, të paktën, do të mbyllem dhe do rreshkem  
disa vjet...  
- Jo, të lutem Luja ime, është e shkurtër jet' e shkretë...

Vetëm prit e ki durim  
sa të thahet varri im!

Tash poeti ra e fjeti, ra e fjet' për mot e jet'...  
Gjëm'e madhe që e gjeti, zonja Lu thërret bërtet  
me oi e ime oi për atë që bënej fli,  
një minutë e dy vili!  
Ç'më gjet, mua ç'më gjet'mua! - ulërin e e zeza grua,  
u plagos e u shkretua!

U plagos e u gjakos, me biçakun e fildishtë  
fije-fije bëri flokët, copë-copë e bëri mishtë...

\*\*\*

*Pas dy ditve vjen një djalë, një djalosh, një bukurosh  
e i thot'zonjës Lu: Ti shëndosh'dhe un'shëndosh!  
Ti e un'një çift i ëmbël, çift i bukur, çift me shije,  
çift, o çift, që s'ka të dytë, si dy kokërrza qershije!*

*Mirpo zonja është besnike, ka dhën'fjalën ka bër'be,  
sa të thahet varri i burrit doemos do rrij' e ve,  
me që varri është i freskët, është i njomë, është i ri,  
që të thahet shpejt e shpejt, zonja Lu i bën veri!*



Zogu I.

Mbreti i Shqiptarëve

Dekreton

emërimin e d'etru Ali Asllanis  
Ministër President në Athinë

Tiranë, më 24. Maj, 1930  
№ 43



*[Signature]*

*[Signature]*

Ministër i Punëve të Jashtme

*R. J. [Signature]*

Dekreti mbretëror për emërimin e Ali Asllanit "Ministër i akredituar pranë Shtetit grek".

## **FSHATI VAJZË**

(Popullore shkruar në gjuhën e atij fshati)

*Në krye të fshatit ka një deli krua.  
uj'i tija akull derdhet në përrua.  
dhe në krahun tjetër varet nga një mal  
një përru' i rreptë me utrim' e val'.*

*Mu në mes të tyre bregu - Allatoj -  
dhe shtëpit' e fshatit si fole fajkoj.  
fshat i babëgjyshit fshati më i mirë  
nga ata që thuhën: Labëri e lirë!*

*Aty nënë shkallë blegërin shelegu.  
Aty përmbi shkallë po gjëmon dybeku.  
rreth e rrotull lëmit djemtë heqën valle.  
nënë rrap, në hije, pleqtë qajnë halle...*

*Luhure qëndisur bedene-bedene.  
seç i paska hije asaj protoene.  
asaj protoene me një furk' në sqetullë.  
që ther e që gris me sy e me vetullë.*



*Andej disa koce shkojnë për në krua.  
këtej bagëtia varet në përrua,  
me krabë në dorë një dylmer djalosh.  
përmbi sy kësulën. vërshëllin përposh.*

*Edhe zilet ziejnë. zile dhe zambare.  
ta shërojnë xhanin pa një pa dy fare:  
pa ler'ajo zile. zil' e deles rudë,  
ajo zil'e shkretë shpirtin të këputë.*

*Dimrit nëpër fshatra. verës nëpër stane.  
e ç'kërkon më mirë në kërë jallane?!*

*Pleqtë qajnë halle: aj. kjo avr e ligë.  
është dreq'i jugës' i është juga shtrigë:  
kurse reja duket mu në maj'te lisi  
një me një. demek. edhe shiu nisi.*

*Qoftë nënë ujë. qoftë kserikojë  
vjen e hardalloset. ç'e rrëfen me gojë.  
vjen e hardalloset. xhano ta ka ënda  
këmba përmbi këmbë. dyqind qase pënda.*

*Të korrë e të shirë. sosen gjith të mjelat.  
gusht e gushtovjeshtë sosen dhe të vlejat.  
Papo zën'e mbarën magje e çetur.  
gjym'edhe kënaçe. ç'paskë në ahur.  
shatin e lopatën, talër e kusinë.*

*laçkën edhe plaçkën, gjith që thua tinë,  
gjithë prokopinë në një krah të mushkës,  
dhe në krahun tjetër thasët e lëpushkës!  
Pasi dy tri herë mushkës i bërtiti  
musi koq'e thanës mu në fshat arriti!*

*Lab, mor tungjatjeta, s'ka më shumë nevojë,  
ky punon për nam e s'punon për gojë,  
s'ka sevda për leka, s'ka sevda për grosh,  
nuk e ha merakun për gjë e për llosh...*


*Po kur ja do qejfi, di për fjal'të nderit.  
di e kren kafshitën nga sqepi sqyfterit!  
Dimrit nëpër fshatra, verës nëpër stane,  
e ç'kërkon më mirë në këtë jallane?!*

---

*Ali Asllani*

**GU-GU, GU-GU, GUGUFTU**

---





*Ali Asllani në Athinë.*

## **KUJTIMI YT**

*Më urdhëron i shkreti mall  
të këndoj aty këtu;  
që të t'i puth buz'e ball  
dhe dy syt e zez' të tu!*

*Rrotull teje çdo kujtim,  
tash që ndodhem larg nga ty,  
vlen si vlen një vetëtim'  
kur është'nata gisht në sy!*

*E kudo dhe kurdoherë  
brohoris kujtimin tënd,  
dhe kur dimri nëpër dyerë  
trokëllin me dor'të rënd'!*

*Se sa bukur ma qëndis  
gjumin tim me atë ëndër,  
e un' mbushem e teptis,  
më teptis e shkreta zëmër!*

*Them të kap e s'mundem dot,  
dhe kur mundem të të kap,  
se si epe... zot o zot,  
kur të kap më ikën prap!*

*Këto lodra m'i ka ënda,  
këto nuse me duvak,  
ball' o ball' seç paske brënda  
xhevaire me vandak!*

## **VAJZAT HEQIN VALLE**

*Vajzat heqin valle.  
njëra flet me vetull, tjetra me qepalle.  
valle deli valle, valle për shtat' qejfe.  
s'paska më mir' valle, se këto me defe!*

*Si veriu verës kur takon me fleta  
fërfëllim tuman-ja, tumanet e shkreta.  
si veriu verës mu në mes të vapës  
xhanin ta shëron zër' i njom i çapës.*

*Çapëzat e vajzës, çapëza pullumbi,  
të lehta si pënda, të shpejta si plumbi.  
edhe vajza vetë në krye të valles.  
musi pikë e lotit majave qepallës.*

*Lum kush i ka parë, kush i ka dëgjuar.  
kur e heqin vallen me shami në duar,  
me një dor'shamia, tjetra dor'në mes.  
ulur të dy sytë, të dy syt'e zes.*



*Edhe flokët derdhur mbi supe të bardhë,  
vajzat heqin valle një nga një me radhë,  
e para, e dyta, e dyta e treta,  
cilado, moj xhane, ka diçka të veta.*

*Lum kush i ka parë vajzat e arbreshit,  
musi dallëndyshet rrafsh i ulen sheshit,  
musi dallandyshet rrotull disa herë,  
prap' si dallandyshet kur i sheh në erë.*

*Dy ato të parat dridhen e përdridhen  
hop, mbi thonj të këmbës, din se si të hidhen  
dor, për dor'të gjitha shoqet rreth përqarkë,  
cilado një flutur gati për në flakë.*

1929

## **VAJZAT DHE DALLANDYSHET**

*Një vjesht'dielli nuk të djek,  
pikë e vesës lot pikon,  
duket fleta që u prek,  
duket filladi që rënkon!*

*Sapo vete qielli vrejtet,  
si një sy që u rrëmbush,  
si një vashëz që po rrejtet,  
s'di sesi dhe s'di nga kush!*

*Lere qiellin që të vrejtet,  
sipas hënës që e zuri,  
po jo vashën që të rrejtet,  
kur bën dorza kalli gruri!*

*Vajzë e vëndit kalli are,  
në pun'ngrihet shum'më lartë  
dhe nga zjarri më e zjarrtë,  
rroftë vashëza shqiptare  
dy herë ar kalliri artë!*

*Dashuria, tungjatjeta,  
midis çiftit të selitur  
dhe me besën ton'të situ,  
është e ëmbël shumë e shkreta,  
është gosti nga qielli zbritur!*

*E do vajzën? i thuaj: eja!  
një çift kite na mjaftojnë,  
dhe në vjesht', kur varet reja,  
dallëndyshet udhëtojnë!*

*Dallëndyshet edhe vajzat  
vinë e rrjedhin nga një derë,  
një vjesht'shkojn'këmbejn'unazat,  
kthehen çift në paraverë!*

## **PYETA VALËT VOGËLUSHE**

*Pyeta valët vogëlushe:  
mu si rrathët e një gushe  
përmbi supe nga një shkumë,  
kush më pak e kush më shumë,  
venë e vinë e shkojnë e shkasën  
dhe përhera për ty flasën.*

*Valëza, o valëza,  
farë e fis me vashëza.  
ku e keni shoqen tuaj?  
Ruaje zot nga erë e huaj!*

*Pyeta zoga, pyeta zogj,  
pyeta zëmrën që m'u dogj,  
pyeta lulet nëpër baça,  
nëpër baça, që un'plaça,  
muaj e vitra po të pres,  
vidi-vidi të thërres!*

Vidi-vidi zogëza.  
farë e fis me zozja.  
ku e keni shoqen tuaj?  
Një minutë e gjat'një muaj!

Vidi-vidi pollumbeshë!  
për ty qaj e për ty qeshë.  
për ty qesha: gjithë jeta  
me gjith'lule, me gjith'fleta,  
u bë fli për atë sy:  
çdo gëzim ta fala ty!

E çdo brengë e mbajta vetë.  
Tash afroji e thënë e shkretë  
dhe un' s'di ku jam, ku vete.  
rroj për ty e vdes për vete!

## **NJË VËSHTRIM I ARRATISUR...**

*Një vështrim i arratisur  
nga qepallët e qëndisur,  
ku është shpirti im skalisur,  
nga dy syt' e zes të tu  
vjen më thot' ashtu kështu!*

*Më thot' jo edhe më ndes!  
Më thot' po edhe më vdes!  
Nata zgjatet edhe zgjatet...  
Ah, kjo nat' me or' nuk matet!*

*E un' mbetem duke lutur,  
lutem yjeve të këputur,*

*Dhe un' lus e kërkoj ty,  
atë vetull, atë sy!  
Se në syrin tënd të zi,  
n'atë sy të zi mazi,  
shën'je buzës sime duket  
si një prush në re kur muget!*



*Një pritje diplomatike në Athinë gjatë kohës kur atje ishte ministër Ali Asllani.*

## **MBI QEPALLE MË TROKIT**

*Mu këtu,  
ku ormisi zëmrën zoti.  
aty kam një guguftu.  
që e koj me pika loti.*

*Natën vjen e bënet dritë.  
bëhet dritë e bëhet yll.  
mbi qepallë më trokitë.  
s'më lë syrin që të mbyllet.*

*Ditën bëhet vetëtimë  
e me krisma e me bujë.  
shkreç në mes të shpirtit tim  
dhe më prish, më bën rrëmujë.*

*Iki larg e ngrihem lart  
kaloj dritë e kaloj hije  
pastaj zë e flas përçart  
dhe në këmb'të saja të bie.*



*E kudo që ajo vete  
më terheq si një pas.  
zot,o zot që s'jam në vete.  
e humbas.humbas.humbas...*

*Dhe buças si val'mbi zallë,  
kur buçet e kur dremit,  
ajo vjen përher'verdallë  
mbi qepallë më trokit*

## **ÇUPËZË MOJ ÇUPËZË...**

I

Çupëzë moj çupëzë  
do t'të mbaj mbi supëzë  
në më do sa un'të dua,  
do t'të mbaj në kupëzë!

Do t'të pi me gotëzë,  
do t'të shtroj notëzë  
nëse vjen e pi me mua,  
do t'të qaj me lotëzë!

Zeshkëzë moj zeshkëzë,  
vogëlushe pjeshkëzë,  
në më jep një puthje hua  
do t'të djeg si eshkëzë!

Valëzë moj valëzë,  
them ta them një fjalëzë,  
as ta them e as ma thua  
e mu bë një halëzë-o

II

*Vashëzë, moj vashëzë,  
sa e holl'e trashëzë,  
falmi flokët pakëz mua  
të ti mat me pashëzë!*

*Fletëzë, moj fletëzë,  
un`poet i shkretëzë,  
këndoju këngëzat e tua  
gjithë jetën e jëtëzë!*

*un`poet i shkretëzë  
bëhem pal e petëzë,  
kam një et, një zjarr po thua  
dy her`zjarr një etëzë!*

III

*Meno, meno moj bletëzë,  
far'e fis me fletëzë  
ti thith lule sa për mua  
un`luftoj me jetëzë!*

*un`luftoj me jetëzë,  
kam një greng një dertëzë.  
Gugu Gugu Guguftua  
më ka lënë të shkretëzë!*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*Tani jam një plakëzë  
shtatëdhjet' pa pakëzë  
dhe tani po atë dua  
një diçka një puthje hua,  
që m'u bëft' farmakëzë-o!*



*Ne ceremonine e ngritjes se flamurit, kur poeti ishte kryetar i  
Bashkise se Viores*


## **JO, JO, SONTE MENDOJ NDYSHE...**

*Jo. jo. sonte mendoj ndryshe,  
do thërres një dallëndyshe,  
dallëndyshen e ke fis,  
do ta nis. ta porosis...*

*Zogu zogës do ja thot'  
vesh për vesh me goj'të plot'  
gjithë këto që, zot o zot,  
them t'i them e s'i them dot!*

*Dallëndyshe. dallëndyshe,  
që nga gjyshe e stërgjyshe  
bij e mbesë në derën time,  
mbar e mblidh këto kujtime...*

*Me kujtime, me lëndime,  
edhe çoja zogës time,  
çoja zogës e i thuaj  
jan'ca lot nga syr'i huaj!*



Skicë ideja e poetit për kullën e flamurit në Vlorë.

## **MOS MË DUAJ TASHI E TUTJE**

Ja, ja plaga që më dha!  
Fjal'e saja kaq e vogël paska dhëmbje të mëdha.  
..mos më duaj tash e tutje', mos më duaj ...

po si e qysh,  
si ta çaj të vetmen zëmër, si ta çaj ta bëj më dysh?

Edhe pika që më ra, që më ra e që më vrau.  
i ra girut dhe e çau, i ra drurit dhe e thau.  
i ra zemrës e duroi, e duroi e e duroi...  
më së fundi e vendosa vetëveten ta çliroj!

E tashi i marr'në kulme  
iu përvështa, pasi sulmi dashka sulme.  
më par' skllëvërit e asaj do ti shtyp e t'i urrej.  
do kap zëmërën dhe ta flak, do kap syrin

dhe ta krej.  
dhe at'herë "nuk të dua" do t'i them.  
dhe do ta urrej!



## OMAR HAJAM, DIL TË DAL

Yjet qënkan baltë.  
Dielli vatër prushi.  
vajzat mjalt o mjalt,  
zoti na falt'.  
rrafsh moj raki rrushi!

Pa çup'e pa kup'  
kjo kaptin'kokalle  
është e rënd'mbi sup  
sa dy thas me halle!

Sado bab'Adami  
mundi e na lindi,  
po Omar Hajami  
diti e na e bindi.

Qënka mos na qënka.  
fundi-Varr i Bamit.  
mbetet vetëm kënga  
e Poet Hajamit!

*Ali Asllani*

---

*Kup'e çup'na thotë poeti  
shtatëdhjet'e tet'vjeçar,  
dy shkëndi eterniteti  
dy her'prush e tri her'zjarr.*

## **PËR KOKËN TËNDE!**

*Si fajkua me sy çelur  
rreth e rrotull nëpër hije,  
ku ti zogëz veje vije,  
ruaj vendin ku ke shkelur!*

*Këto gjurma unë t'i ruaj,  
këto gjurma gji-ergjënda,  
ku rreh zëmra ime brenda,  
s'mund të shkel'një zok i huaj!*

*E ja-ja, për kokën tënde,  
si një xhinde nëpër mure,  
duke thithur një pagure,  
kërkoj kohën që më çmënde!*

*Be për ty, për qiell e dhe,  
dora ime kurdoherë  
nëpër mure, nëpër dyerë  
skalish emrintënd, edhe*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*më plaç buzën pleqëri  
që sa vete lëshon lule.  
lëshon push të njom'mbi tulle  
dhe këndon si zok i ri!*

*Zok i ri për mrekulli  
për një sy të zi të shkrete.  
me gjith'moshen gjashtëdhjetë  
un'zbras kupa me dolli!*

## **GUGU-GUGU GUGUFTU!**

*Gugu gugu guftu!  
as një zë...  
mbase lemza shkon e zë!*

*Mbase shkon e dëgjon ora,  
mbase këthenet gguguftuja...  
si e lash, m'u thaftë dora!  
guguftun' me shtatë tuja?*

*Dikur bija, si fajkua,  
shtek më shtek e në sinor,  
duke shkelur përmbi thua,  
ajo priste në oborr...*

*E ajo e un'e Zoti,  
na të tre dhe hiç njeri,  
dhe në pika të çdo loti  
yll i fatit rreth flori!*

## **VISHET MËNI, ZVISHET VASHA...**

1

*Çeli edhe trëndafili,  
Shemr'e manushaqeve,  
kili-kili, kili-kili  
mollzave të faqeve!*

*Edhe mëni, na u vesh,  
na u esh me fleta mëni,  
vidi-vidi pëllumbeshë,  
është juaja hëna hëni!*

*Vishet mëni, çvishet vasha,  
përgëzonen llër'e supa...  
Un', moj xhane, s'e bëj hasha,  
më pëlqen t'ju pij me kupa!*

*Gjith jetën pas ju rash  
Shtek më shtek e kënd më kënd,  
midis ju dhe mua tash  
dhe për linja s'ka më vend!*

*Nuk ka mbetur vënd për linja,  
lemni, pra, t'ju qaj me lot,  
sepse femra del nga brinja,  
urdhëron i madhi zot!*

*Në të till' të holla punra  
unë u bëra palë e pet',  
s'mund t'i vete zemrës kundra,  
jam artist e jam poet!*

*Ja, ja mëni na u vesh,  
na u vesh me fleta mëni,  
vidi-vidi pullumbesh'  
është juaja hëna: hëni!*

*Vishet mëni, çvishet vasha...  
un', moj xhane, s'jam i huaj,  
dhe për zotin, s'e bëj'hasa:  
jam me ju dhe jam i juaj!*

## 2

*Çeli edhe trëndafili.  
shemr' e manushaqeve,  
do iu thur' një këng' bilbili  
mollzave të faqeve!*

*Mollzave të kuqe flakë,  
flak' të kuqe xixillonjse,*

*një vandak me ar është pakë  
për një puthje përvëltonjëse!*

*Mollzave që, pika mua!  
me një pik' të zez'në mes,  
që t'i thith një herë si dua,  
jam gati dy her' të vdes!*

**3**

*Çeli edhe trandafil  
shemr' e manushaqeve,  
do t'i ysht me magji stili  
gropëzat e faqeve!*

*Gropëzat që, pika mua!  
gotëza të mbushur prerë,  
që t'i thith një her' si dua,  
jam gati të vdes dy herë!*

*Do t'i ysht t' i bëj barmish,  
do t'i bëj bëj fitil për zemër,  
do të prishem dhe do prish  
dhe do bëj të bëhem emër!*



*Ja, ja, mëni na u vesh,  
na u vesh me fleta mani,  
vidi-vidi pullumbash',  
është juaja hëna:hëni!*

*Vishet mëni, çvishet vasha...  
un', moj xhane, s'jam i huaj,  
dhe për zotin, s'e bëj' hasha:  
jam me ju dhe jam i juaj!*

## **KATËR STINA KATËR ÇAPA**

I

*Vjeshtë...*

*Nëpër hije s'ka më shije,  
lot'i par' dhe më i thjeshtë  
është fletë e gjor' që bije!*

*Nëpër dega, nëpër gjethe,  
dor' e erës po trokit:  
me rënqethje si në ethe,  
fillon pema psherëtit!*

*Sosi kënga në fole,  
hyri reja në kufirë,  
dallandyshja, ler' e le,  
ja nis këngës lamtumirë!*

*Dallandyshja ime, haj!  
do më lër' e do më shuaj;  
ku do shkeli këmbë e saj,  
loti im do jetë i huaj!*

II

*Shkoi dhe vjeshta me sa pati...  
vargje-vargje varet reja,  
zbriti drër' i madh nga shtrati,  
po andej nga zbret rrufeja!*

*Bota mbytet nga një mjegull,  
dita thyhet, nata rritet,  
në obor e shkreta pjergull,  
sa po vete po ronitet!*

*Qielli ulet, ulet, ulet  
rreth e rrotull tym e ujë,  
reja vjen, mbi supe ngulet,  
er' e egër bën rrëmuje;*

*Era vjen me duf si plumbi  
dhe nuk le fole në vënd,  
dallëndyshja ime humbi  
edhe unë i humba mënd!*

III

*Kalon koha dal' nga dal',  
nata thyhet, dita rritet;  
diell'i dimrit rral për mall,  
si sorkadh me çap vërtitet!*

*Mbi një degë o mbi një tjegull  
nunurit një zog i gjor',  
në oborr e shkreta pjergull  
merr një hov pranveror!*

*Ja dhe shkurti shkurtabiq  
s'le dy gurë në një qoshe,  
po vesh trupin lakuriq  
të bajames bukuroshe!*

*Mars, o mars me huqe shumë,  
një rremall e e një nopran,  
aty vaj e aty shkumë  
aty qesh e aty qan!*

*Është e gjer'sa është'një botë,  
dhë ne vjen me ca rrëmbime,  
është i thell'sa është'një lotë,  
po i holl sa zemra ime!*

#### **IV**

*Kur bën koha diell e shi  
merimanga paska dasëm,  
s'di, për zotin, po tashti  
un'dhe zemra ime shkasëm!*

*Mëndja më vete ku nuk vihet...  
e më tej, e më përtej...*

*një pëllumb që di e ngrihet  
ai e di se ku do vej!*

*Ku nuk vete mendj'e shkretë,  
bënet shkumb dhe mbi tallas,  
un'po varem tatëpjetë...  
ajo shkon e shikon pas!*

**V**

*Paravera me bilbila  
koha qesh dhe buza qesh,  
diçka thon'për trëndafila  
goj'për gojë e vesh për vesh!*

*Kridhet bota në stoli,  
në stoli e në sedefe,  
dridhet zëri në vjoli;  
dor'e vajzës' rreh dy defe!*

*Ngrihet kupa me dolli,  
një dolli me tre shëndete,  
rrotull zoga, mes-kalli,  
dy për zogën një për vete!*

*Pjesa ime tepër pakë:  
pi dy kupa, heth një sy,  
mezi marr një pikëz flakë  
sa për zemër... gjer aty!*

**VI**

*Thon'se shiu muajt maj  
nëpër dete bën sedefe  
dorë e vajzës punon paj'  
dor'e majit bën gjergjefe!*

*Pik, ergjendi vjen me fate,  
e çdo pik'me këmb'të mbarë,  
nëpër llëra, nëpër shtate  
tingëllin si pika ar!*

*Erdhi vera përsëri  
kalipeç mbi shtiza dielli,  
bejk'e stanit buz'flori  
del e pret me kënga fyelli!*

*Përsëri dhe përsëri  
përqafohen fladi, fleta,  
ah, kjo kënga-dashuri  
është'e ëmbël shum e shkreta!*

*Ngrihet kupa me dolli,  
me dolli e me shëndete,  
un'po rri e vërshëlli...  
as për zogën, as për vetel!*

**VII**

*Shkoi dhe vera me aq bujë,  
shkoi me gjith'ato stolira,  
plaç, moj ver', që për pak ujë  
thave lulet më të mira!*

*E një vit i gjithi shkoi,  
katër stina, katër çupa,  
un'kërkoj, kërkoj kërkoj...  
djalërin'që mbeti prapa!*

*Aty brenda kam ormisur  
me kujtime, me gatime,  
thellë e thellë i kam skalisur  
në bërtham'të zemrës sime!*

*S'kalon koha, kaloj unë,  
jet'o jeta e flamosur.  
Jam në gusht, dhe gusht e gunë...  
plaça un'që paskam sosur!*

## **PLAÇ, O ZEMËR, QË S'U PLAKE!**

*Me furi e me uturime  
rreh rrufej'e këtij malli,  
un'si zok që mbledh thërrime,  
çukas fletët e një falli...*

*Dijka bën për zëmra falli  
me një mbase, nga një herë,  
mu në buz' të çar' nga malli  
riçel gazin që m'u terë!*

*Dikur çelet buzë e gjorë  
me një mbase, me një mund...  
musi lulja nënë botë  
kurse era vjen e shkund!*

*Me një mbase, me një mund  
varur shpresës varfanjake...  
plaç', o mall, që s'paske fund  
plaç, o zemër, që s'u plake!*



## **THEM TA THEM...**

*Nuk' është' et,  
nuk ështëë zjarr,  
është' një mall i thellë i shkret'  
që në zëmër më ka marr'!*

*Më rrëmben e më rrëmbush,  
e më plas e më përplas,  
gjith ditën kupa mbush  
gjith natën kupa zbras!*

*Zbras me etin që s'u vak  
e më duken...sihariq,  
yjet nuse me duvak,  
hëna vashaz lakuriq!*

*Po në kupa mbushur prer'  
un'kërkoj një tjetër gas,  
zëmra digjet ylyver,  
mëndja vete asaj pas!*

*Mëndja vete, e ku vete?  
Orë e çast e në një vënd...  
Plaça un' që s'jam në vete;  
plaça un' që prishem mënd!*

*Kërkoj fleta borziloku  
nëpër fije ar përçeme,  
kërkoj gjurmat e një zogu  
nëpër fleta të një peme!*

*Un' kërkoj atë në bot',  
atë gas e atë lot,  
atë... hej që, zot o zot,  
them ta them e s'e them dot!*

## **AH KY MALL...**

*Ah ky mall, ky mall i çmëndur  
që më bën e flas përçart',  
që më bën e ulem dëndur  
ulem posht'nga lart e lart!*

*E që pres në prag të derës  
gjith'në zjarr e gjith'në etje,  
mbase vjen veriu i verës  
e më sjell një përshëndetje!*

*Të më sjell' dhe futem thellë  
nëpër rrokje, nëpër rime,  
ngreh me arte një kështjellë  
me fuqin'e vjershës sime!*

*Po aty më trubullohet  
zemra ime prishanake,  
turbullohet e s'kullohet  
me një pyetje qesharake:*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*Vall'më do? dhe mbi këto  
prish një lule kot më kot  
A më do a nuk më do  
Herë e fundit do ma thot'!*

## **MË LEJON TA PUTH NJË HERË?**

*Më lejon ta puth një herë  
mu në cep ku është e thyer  
atë vetull?*

*- Jo, tashti,  
shih si dridhet, do bjer'shi!  
Kur qerpiku më lëvis  
një me një dhe shiu nis!  
- Po në mollëza, në faqe?  
- Jo sot, nesër ose dej  
kur të vemi atje tej,  
për të mbledhur manushaqe.*

*- Po në sy? .....*  
*- Përse, të lutem?...*  
*Se kur ti më puth në sy  
syt më mbushen që të dy,  
trubullohem e këputem!  
- Po në buzë?*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*- Aty po,  
buzën time do t'ta jap,  
hënë e ngrenë bëhet prap',  
bën si di e bën si do!*

## **NJË MOTIV KINEZ**

*Erën edhe shiun unë, dikur shumë i kam urrejtur,  
se sa flisja ebërtisja kundra qiellit kur ish vrejtur!  
Një dit' ra një shi i madh, sikurse u derdh me shtëmbë,  
një çup'lagur tepër rëndë, që në krye gjer më këmbë,  
që të mundej të ndërronej, erdhi brënda dhe u çvesh,  
çupë o çup', për kok'të saja, guguftu e pullumbesh'!  
Por kur plasi edhe era sa që llamba na u ndal,  
me një fjalë...  
që at'herë erë e shinë që të dy i adhuroj  
edhe qiellin e uroj, e ja ja si fluturoj!*

## **GUGU-GUGU-GUGUFTU!**

**I**  
*Gugu-gugu-guguftu!  
Unë i yti flas këtu,  
do më vish a s'do më vish?  
me qerpik të syrit tim do fshij vëndin ku të rrish!*

*As më reja këtë hëna ku e varte vala zërin,  
ku humbiste dora bizën, ku humbiste biza përin,  
ku përleshej flladi floku, rreth saksira borziloku,  
ku lëshonte dega hije, e ngarkuar me fole zogu.*

*Ku si bleta, zoga bletë, që fsheh mjaltin nëpër hoje,  
kemi fshehur lotët tanë dy her'mjalt i bardhë në hoje,  
lotët tanë, që tashi unë, duke qar' me ngashërim  
i kërkoj si bar shërimi për një plag', që s'ka shërim!*

*E, pra, eja e më eja si dikur, që veje vije,  
ja si erdhi pikë e diellit nëpër fleta hop në hije,  
e, pra, eja e t'ja nisëm, atë këng' ta përsërisëm  
ti me bizë e un'me buzë, të punojmë e të qëndisëm!*



*Rreth e rrotull nëpër baça, nëpër baça që un'plaça,  
që nëmes të dy gishtrinje do të thyeja në të paça,  
të rëmojmë e të kërkujmë  
për ato që van' dhe s'vinë të rënkojmë e të rënkojmë!*

*E ti zemë e t'i përzemë ata zogj që bënin zhurmë,  
këmbë e zogut, s'di për zotin, këmba jote s'bënte  
gjurme...*

*Këmba jote aq e lehtë, aq e shpejtë e aq ngadalë,  
sikur flutur, sikur fletë, sikur shkumë, sikur valë!*

*Un' po falem e po lutem, ku e gdhim' e ku e ngrysëm,  
ku të shkretat përqaftime dikur mbeteshin për gjysëm...  
Dhe këtu në dhe të gjallë dora jote të më fus',  
që të rroj edhe i vdekur, të vazhdoj për ty të lus!*

## II

*Do më vish a s'do më vish?  
Me qerpik të syrit tim do fshij vëndin ku të rrish!  
As më eja e më eja përsëri e përsëri:  
do të thur një këng' të njomë, do të qaj me stil të ri!*

*Si një zok, që lë degën në lëvizje të një flete,  
përse druan e përse dridhe, e përse këndon me vete?  
e përse këndon me vete, e përse ja thua ndryshe,  
nuk është' par' në gji të gjëmbit të këndoq një dallandyshe!*

*Ty në zemër diç të zjen e i ul ato qepalle,  
ato syskëza qepalle të radhitur' si në valle...*

*Diç të zjen e të përzjen:*

*Juve xhinde, rrofshi, qofshi, i paudhi ju gënjen!*

*Ju flet kundër dashurisë, po për zotin, moj, për zotin,  
në shërbim të dashurisë perëndia krijoi lotin.*

*Pikë e lotitm që lëshonet urtë e but'për dashuri,  
bën atë që në faltore nuk e bëjnë shtat' qiri,  
nuk e bëjnë shtat'qiri, shtatëdhjet e shtat'qiri,  
e, pra, eja e më eja, përsëri, e përsëri!*

*E, pra, e t'ja nisëm, atë këngë ta përsërisim...  
ti me bizë e un'me buzë të punojmë e të qëndisim...  
Vate jeta e u kthye, vate dita e u ngrysëm,  
eja shpejt e t'i mbarojmë ato puthje lënë përgjysëm!*

### III

*U bubu, moj guguftu,  
po ku jemi, ku e ku?!*

*Para kartës rri e kqyr...*

*midis ty dhe mua, haj, gjysmë e botës paska hyr'!*

*Syri syrit i është'larg, zemra zemrës i ështëë afër,  
un'kurbani yt i varfër*

*kam një zjarr në kraharuar për atë që s'qemë na bëri!*

*E ky zjarr i grumbulluar më jep vrapin e një zëri!*

*Ja, ja, valët nëpër dete se si vinë e se si venë,  
Vala valën e tërheq, zemra zemrën e rrëmben!  
Le të vimë e le të vemi,  
për të parë ata që kemi, për të qar' ata që s'kemi!*

*E ku janë ata që vanë, e ku vanë ata që s'janë,  
t'i vaditim me lot syri lulet tona që u thanë!  
Se sa bëmë e se sa tham'...  
gugu-gugu ku të kam?*

*S'di, moj xhane, po un' vetë, ja ku jam e ja si jam...  
po si jam, mos qofsha kurrë, s'di se si e s'di se qysh,  
si e vetmja zemra ime, si u ça u bë më dysh!*

*Le të vimë e le të vemi,  
ne që jemi më s'do jemi!  
si që ishim më nuk jemi!  
Diçka kishim që s'e kemi!*

*Thon'për mua, tel i thyer, si e tjerja nuk e tjerë,  
thon' për ty flori përherë...  
Thon' për ty përher flori,  
nusëron me stil të vjetër, po të djeg me zjarr të ri!*

## **NJË ËNDËR LOZONJARE**

*Takër-takër nëpër zeje  
fërfëllim' që vjen prej teje,  
takër-takër zër' i lehtë,  
po vjen zoga fsheht' e fshehtë!*

*Nisi zëri të më teret  
go...go...goja po më merret  
eja afër e më afër,  
jam kurhani yt i varfër.  
Ti një çap e un' dy çapa.  
Lumthi un' që tash të kapa!*

*Ti si gjysëm perëndeshë,  
un'me zjarrin tim rrebesh  
do të shpije në obor,  
do të mbaj unaz'në dor'!*

*Do të shpije në shtëpi,  
do të shtrydh e do të pi,  
do të shtrydh si rrazakinë*

*do të pi si pi rakinë.  
U bu bu, moj raki rrushi  
do të pi me kupa bushi.*

*Do të... djall i një këndezi,  
ky kasnec i çdo mëngjezi,  
të dy krahët i trokiti  
e thërriti e bërtiti!...*

*Hop e cop e në dritare  
shikoj rrotull... s'ka gjë fare...  
plaç moj ëndër lozonjare!  
Ish një ëndër, vajti, iku,  
e un' mbeta sa më piku  
me një zë të çjerr': kikiku!*

## **ME TY ZËMRËN DO TË KOJ...**

*Si na thon' ata që vanë  
duke folur me lavdi,  
në çdo zemër ka një zanë,  
zan'e zemrës sime Ti!*

*E ç'më duhet nga kam ardhur?  
E ç'më duhet ku po shkoj?  
Sado mosha më ka zbardhur,  
me ty zëmrën do ta koj!*

*Do të kap e do të shtroj,  
një nga një t'i nëmëroj  
se vall' rreze ari paskan ato syskëza qepalle,  
ato syskëza qepalle të radhitur si në valle?*

*Sa vall' fije ari paska ajo vetull' aq e zezë?  
Sa vall' pika rrushi paska syri yt që djeg e ndez?  
Dhe sa nuse, nuse syri, po notojnë aty brënda?  
Njëzet vjet me radh' i putha, po, për zotin, nuk u dënda!*

**S O U I.**

**Kryetari i Shqiptarëve**

**Këtu propozimin e bërë në shkencën Nr. 2276 datë 10-XI-1937 të Kryeministrit, bërë në shkencën Nr. 10720 datë 10-XI-1937 të Ministrit të P. të Mbrojtjes,**

**L E J O R**

**S. Ali Asllani, Kryetar i Bashkisë së Vlorës, për të shpirtë dekoratën "Officiers d'Academie" të akorduarë prej Shkollës së Tij Kryetarisë të Republikës Franceze.**

**Tirana më 2 Shkurt 1937**



*Ali Asllani i lejohet mbajtja e dekoratës së lartë "Officiers d'Academie" akorduar nga Kryetari i Republikës Franceze.*

## **PËR T'JU FALUR BUKURISË**

*Kur më vete, kur më vjen,  
më rrëmben e më rrëmbush, më rrëmbush  
e më rrëmben:  
ti përher'e përgëzuar dhe e tëra fllad e fletë,  
un' përher' i gjunjëzuar dhe i tëri pal' e petë!*

*Kur më vjen e kur më vete  
edhe hijen them ta mbleth dhe ta mbaj në gji  
për vete...  
hijen tënde, frymën tënde përvëlonem që ta mbleth,  
përvëlonem që ta thith dhe vështrimin që më heth!*

*Vidi, vidi pëllumbeshë,  
para teje vij e falem me gjith' zjarrin tim rrebesh,  
dallandyshtet, që në dimër nuk e dim' ku ven' e futen,  
dhe ato që prej së largu për ju vajza për ju luten...*

*Për ju falen, për ju luten,  
për t'ju falur bukurisë digjen yjet dhe këputen!*



## **VETËM JETA S'MUND TË MATET**

*Dhe ajo që m'u duk mua e përhershme shkoj e vate.  
Vate jeta ime vate, më la vetëm një kujtim.  
S'di, i ziu, ç'është'kujtimi: vetëm shkrep si vetëtim  
e më ndrit e më tregon gjurmëzat e zotris' sate.*

*Thonë lindi me këmishë, për atë që paske fate,  
me që unë të dua ty, paskam lindur me këmish',  
s'di, i mjeri, ç'është'këmisha, vetëm ish ashtu si ish.  
midis mishit dhe këmishës futej dor' e zotris' sate.*

*Thonë paska paraise, gjith' lulishte e pallate,  
tufa tufa me hyrira, vargje vargje me humrira,  
s'di, i ziu, ç'është' hyrja, por hyrirat më të mira  
s'mund ta ken', tú bëfsha unë, atë zjarr të zemrës sate.*

*Paska vënde gji-ergjënde e pallate me shtat pate,  
ku ka defe, ku ka qejfe, ku ka çupa me kaçupa,  
s'di, dhe s'di, se ç'është' kaçupi, më pëlqen më  
tepër kupa,  
kur ma mbush e kur ma jep ajo dorë pa mëkate.*

*Ali Asllani* \_\_\_\_\_

*Dy të tretat e një kohe, të një shekulli që vate,  
vate jeta ime vate, me 'të bashkë van' dhe fatet,  
s'di, i ziu, se ku vanë, vetëm jeta s'mund të matet  
veç me ditët që kalova në prani të zotris' sate.*

## **DO T'I SHTRYDH TË DY SYTË**

*Un'jam un', saksi e vjetër!*

*Lule gjirit që stolisa shkoi stolisi një gji tjetër,  
Un' e nisa e stolisa me ç'i jep e s'i jep sisa  
dhe me këngë ylyveri buz' e gushë ja qëndisa.*

*Nëpër vapëz i dhash' hijem nëpër hije er'e shije,  
i dhash' shije poezie, gjith' fuqit' e një magjie,  
gjith ato, që fllad i ëmbël nëpër lule mbar e bije,  
ar'e diellit me tallazë, ar' e hënës fije-fije,  
dashuria me dollira dhe me thelp lajthije pije...*

*Po u bë ajo që s'bënej, si, pra, zemra do duroj',  
syri lotin ta qëndis, loti syrin ta harroj?  
Si, pra, zëmra do durojë un' saksia tash të vuaj  
edhe këngë e gjirit tim të këndo' në gji të huaj?*

*'Jn' e nisa i stolisa me ç'i jep e s'i jep sisa,  
dhe me këngë ylyveri buz' e gushë ja qëndisa,  
buz' e gushë ja qëndisa, e ormisa mu nën zemër  
plasi hëna ziliqare që shikonte me sy vëngër!*

*Më së fundi i dhash' lotin, kryepajën time pajë,  
i dhash' lotët që pikonin ku i shkelte këmbë e saj',  
i dhash' vjershën time valë, dy herë valë tri her'zjarr,  
që buçet në maj të penës edhe bënet këng e marr',  
këng' e marr' e mallit tim, që tani e paskëtaj  
do t'i shtrydh të dy sytë nëpër gjurma të asaj!*

TRISKË ANËTARËSIJE

Z. *Ali Asllani*

banues në *Tiranë*  
është anetar i LIDHJES SË  
SHKRIMTAREVE TË SHQIPNISË.

*Tiranë, më 5-11-1946*

Lidhjen e Shkrimtarëve të Shqipërisë

SEKRETERI



Nënshkrimi i Anëtarit

*Ali Asllani*

*Këjo triskë është personale*

Karta e anëtarësisë së poetit në Lidhjen e Shkrimtarëve të Shqipërisë më 1946, si njëri nga themeluesit e saj.

## **M'IKU DJALËRIA...**

*Po mendonem e mendonem, përsëri e përsëri,  
ndër ato të vjetra gjurma më pikon një lot i ri...  
Po mendonem përsëri për ato që s'përsëriten,  
vetëm vetëm nëpër dega midis zogjve pëshpëriten...  
Midis zogjve pëshpëriten, midis shkumës edhe valës,  
ku aty, të shkretit mua, s'më arrin fuqi e fjalës!*

*Gjith' kujtime, gjith' mejtime, palë-palë, gas e lot,  
më besnik se është'kujtimi s'paska tjetër gjë në bot'....  
Dhe tani që çdo gjë vajti, çdo gjë vajti dhe më iku,  
ky me vjen e më këndon mu në maj' të një qerpiku!  
Këndon këngën që pushoi të një kroi që shteroi.  
këndon hijen që pat derdhur një pullumb që fluturoi...*

## **MOSHË O MOSHË, QË MBETE PAS**

*Për kujtimet s'paska shëmbje,  
paska lotë e paska dhëmbje...  
Në bartham'të këtij loti  
kërkoj gjurmat e një moti...*

*Mot, o mot, që mbete pas,  
me ty dua që të flas,  
të të vihem pas e pas  
sa të plas e të gajas!*

*Jam xhindosur nga një mall,  
pra me syt' që kam në ball,  
nuk vështroj atë që vjen,  
nesër, ditën që më vlen,*

*po vështroj atë që shkoi,  
dhe kërkoj, kërkoj, kërkoj...  
Mu në sqep të një pullumbi  
këkoj këngën që më humbi!*

\*\*\*

*Nashti rroj po ja si rroj:  
kur shkojn' vajzat bukuri  
i vështroj e i vështroj,  
heq kapellën e nderoj,  
varur buzë edhe turi!*

*Vij vërdallë në shtëpi,  
Dhe me qën, se s'jam i zoti  
të punoj, të puth, të pi,  
rrah të vetmen prokopi,  
gruan time kot së koti!*



# **HANKO HALLA**

*(Poemë)*

## ***Pjesa e Parë***

I

*Halla ka marr'mashën, urat po i shkrep edhe merr e jep,  
trungu i ullirit digjet me gazep,  
digjet mala-mala, sidomos bujashka;  
në dimër,moj motër, zjarri shumë u dashka!*

*Deh i lumtë goja kush e tha më par'  
xhan e shpirt, o burrë, xhan e shpirt, o zjarr!  
Buk' të that'në sofër, buk' dhe asgjë tjetër,  
po agai sa malet edhe zjarr në vatër!*

II

*Rreth e rrotull zjarrit nunuris njeriu,  
si gjithkush të tijat plaku dhe i riu...  
Fjala e të rinjve çelet me përrallë,  
me një gjum të ëmbël gati mbi qepallë:*

*Ç'është njëzë e njëzë, ç'janë ata dervishë,  
ç'janë ata dervishë, kryet me fildishë?  
ç'është ai që s'hahet, ç'është ai që s'piket,  
edhe nëpër xhepe kurr e kurr nuk vihet?*

*Fjala e të rinjve çelet me përralla.  
Brezi yn'po dihet, zëm'e qajmë hallë...*

*Një ka bër'të mira, po s'ka par' të mira,  
tjetri qënka pjekur keq në takllaira;  
plagve të atia nuk iu gjënd melhemi,  
dertet e këtia nuk i merr kalem;  
njëri s'paska miell, tjetri s'paska thes,  
fundi fjalës bota qënka e pas bes'!*

*Muaj i shënëndreut, muaj i flamosur  
ngryset edhe s'gdihet, nata s'ka të sosur.  
Shum'i hidhur qënka, shumë e shum'po thuaj,  
sa dhe pulat s'pjellën, brënda këtij muaj.  
Enët mbahen mbyllur, qypa, shtëmba, butet,  
pasi karakëshi vjen e brënda futet!*

*Netët shum' t'errta, dita shum e vrazhd',  
mbetëm mu si pela mbyllur në një grazhd;  
pa le llafazankat vinë e na bezdisën*

*pasi kot së koti zën e kararisën;  
ruana zot nga fjala, zgjatet edhe zgjatet  
sa me pash njeriu s'ka se si të matet!*

**III**

*Xhiko Xhevahirja, Halla dhe Xhixhia  
Krushka Hanko Shega edhe xha Inxhia,  
Bulla Qeribaja, dadara gegera  
zonjat e mëhallës, që na vin'nga hera  
veshur kadifera, veshur me shalira,  
rroba rrob'Stambolli, s'paska më të mira!*

*S'paska më të mira, po për sy të ballit,  
bora më e pastër është' në maj' të malit,  
rroba më e pastër është' mbi trup të Hallës,  
mu si shkum' e bardhë mu në sup të valës!*

*Edhe rrethi Hallës, rrethi atij gjiri,  
ruaj zot nga syri, mu si prush floriri.  
Duket der' e parë, bukuri e derës  
çpuan mbi katër stina stina e pranverës!*

*Ngulur mbi shiltera, gjith'ato shiltera  
hapur gjer te dera, shum' e shum' të vyera,  
me ixhat Janine, lule ylyver,  
dy mexhide topin Halla i ka bler'!*

*Pa dëgjoni, zonja, - nisi Halla plak', -  
do ju them një fjalëz, fjalë pa kapak!  
Erdhi kohë e keqe, koha e flamosur,  
na u prish dynjaja, bota është' marrosur!*

*Sot një lajmës erdhi, e mir' se na erdhi,  
pati, çar nuk pati, një nganjë i derdhi;  
lajkat më të rralla, lajkat më të holla:  
mbret mbi pem'limoni, mbretësh dhe molla...  
Fjala vinte rrotull, rrotull e vërdallë,  
ç'do t'i thot' limonit mollë e kuqe vallë?*

*Thuaj e thuaj e thuaj edhe shumë përralla,  
herë i terej zëri, herë i terej fjala,  
herë i terej fjala, herë i terej zëri,  
dale me ngadale mos këputej përi,  
herë i çelej buza, herë i çelej gazi  
dhe e dha e mbushi...pasandaj e zbrazi:*

*Qënka mos na qënka, nja hadi bilmes,  
na e do për nuse çupën, time mbes!  
Fët e fët e mora një kongjill nga zjarri,  
nxora dhe nga xhepi një gjerdan prej ari:  
"Na- i thash', - trazoi", nuk trazohen kurrë,  
njëri për në gushë, tjetri për në furrë".  
U" më mart' të keqen, dhe m'u bëft'kurban  
far, e fis i tia anë e mban' ku jan",*

IV

Halla thot'të drejtën, çupa si dy sytë  
si do bënej nuse, nuse e derës s'dytë,  
kurse Hanko Halla rrjeth nga der' e parë?  
Bota të mos kishte disa pashallarë,  
soj i Hanko Hallës do ta kish me hak  
që të kish saraje dhe të ish oxhak;  
Halla do të quhej Hallë pashallesh',  
fjala e saj do ishte mu si vësh në vësh;  
Halla do të bënte si t'a kish istekun,  
eja-ik mileti, merr e puth etekun!

Gjyshi paska pasur shum' para të thata,  
paska pasur arka plot me kollonata,  
paska pasur mbushur araka e sënduqe  
me para të bardha, me lira të kuqe;  
gjalpë e vaji i tyrej derdhej si përrua,  
katër teste qypa kishin në katua,  
katër teste qypa, katër teste zgjoje  
mbushur me pekmeze, mbushur mjaltë e hoje!



**INSTITUTI MARRËMBLEDHËS I STUDIMEVET SHQIPTARE**

Nr. Prot 41/2

Tiranë, datë 28/IV/1944

Shkurtimi :

Objekti e adresës Nr. 41.

I Ndërti Shok -

Kam kënaqësinë t'ju përcjell  
Dekretin e Kryhillit të Naltë që ju emnon Më të  
Rendshëm të Institutit Shqiptar për Studime e Arte.  
Pranija e Juaj në rrethinë e In-  
stitutit nuk është vetëm një njohje e meritave të Uaja  
kulturore por njëkohsisht dhe një nder e çështje për In-  
stitutin.

Përgëzime të sinqerta.

Zav. KRYETARI :

(O. Paskal)

I Ndërtit t'ni

ABLLANI

Antar i Inst. Shqip. për Stud. e Arte - Tiranë

Letër e Odise Paskalit drejtuar poetit më 1944.

HANKO HALLA EV-1

Halla ka mbar mbarën e rreze po i shpreh,  
 Përvojat e kullit dëgjim me qazaf;  
~~Keqja mbar mbarë t'ni olam~~  
~~Keqja mbar mbarë t'ni olam~~ bregu e kullit,  
 Siç vrit mbar mbarën zjarri e kullit shpreh!  
~~me mbar mbarën~~  
~~me mbar mbarën~~ me mbar mbarën me mbar mbarën  
 Dëshirë e kullit qazaf e kullit me mbar mbarën,  
 Këtu e kullit e kullit e kullit e kullit e kullit!  
 Dëshirë e kullit me mbar mbarën e kullit e kullit,  
 Go e kullit me mbar mbarën e kullit e kullit!  
 Dëshirë

Qazaf e kullit zjarri me mbar mbarën qazaf.  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;

Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;  
 Qazaf e kullit e kullit e kullit e kullit;

Faksimile nga dorëshkrimi i poemës "Hanko Halla"



Tirane 17/10/1963

Shpreh 1 Nderti dhe 1 dashuni 2, Ali Asllani,

Më takimin që pata me Ju para disa muajsh patët mirë-  
sim të më lexojshi letrën që Atë Gjeçevit Ju shkruante në  
vj.1920 prej kuvendit të "Rubikut. Të parën herë pata ra-  
son të ndiejshme prej gojës Sëj në përvjetorin e 40-vjetor  
si tij në tetorin e vj.1945, kur u mbajtën mbledhja e Lidhjes  
si "shkrinartëvet.

Më këto raste e fundit Ju më dëftuat di, ka me rëndë-  
si "shritjen e Atë Gjeçevit në kryengritjen e Vlenës kundër  
Italjanëve, se si ai paska insistue dhe paska thanë, se pa  
shpresë një peshkë dhe pa u dërdhë gjak "taljanët nuk do-  
lin këndej. Po në atë rast më folët edhe për patriotizmin e  
Dem Mark Vases. Kishe për të Ju qenë shumë mirënjohës, po  
të më jepshi diçka me shkrim, mbasi unë, ka de kohë, jam tue  
mbledhë të dhana mbi Atë Gjeçevin.

Më shpresë krejt të ngulët se do të më çoni në vend  
këto dëshir që asht një kontribut i vlefshëm për ndritjen  
e figurave patriotike të atdheut timë të dashun, dhe që  
Ju më len ndër edhe Ju, dëshmehem me nderime të shqueme dhe da-  
shuni. Të Ju falënderue qysh tash, ju lutem të pranoni për-  
shëndetjet e mijs të sigerta.

Atë Viktor Volaj, Francëkan

Letër e At Viktor Volaj drejtuar poetit, ku i kërkon të dhëna për veprimtarinë  
e Shtjefën Gjeçevit.

**V**

*Pastaj - vazhdon Halla - patëm disa halle,  
malet u bën'fusha, fushat u bën'male;  
fushat u bën'male, malet u bën'fusha,  
humbi dhe floriri varur nëpër gusha!  
Dale me ngadalë humbën gjith'stolirat,  
humbën gjith'të mirët, humbën gjith' të mirat  
humbi dhe xhanfesi, humbi dhe atllasi,  
prej të katër anëve damëllhana plasi!  
Humbi arma e burrit, humbi palla e lar',  
humbi rroba e gruas kredhur gjith' në ar!  
S'mbeti ar në xhepa, ari shkoi e shkriu,  
s'mbeti gjak në zëmra, gjaku i burrit ngriu!*

*Ku është brezi i vjetër, brez që s'bëri mes?  
Dhe që di e shuan dhe që di e ndes?  
Floku i Zi i tyre si lele asllani,  
ball i gjërë i tyre digjej yll karvani;  
fjala e fortë e tyre një e njësh me vulë,  
shtati i hollë i tyre hedhur sa një kulë!*

*Ku është Labëria, Labëria e parë,  
vëndi i jataganit, vëndi i pallës s'larë?  
Ku është zonja, e vendit, dorë e llër çeltnik,  
qafë e çap sorkadhe hedhru me deftik?  
Qafë e çap sorkadhe, me deftik vërtitur,  
dhe me thelp lajthie rritur e gostitur?*

*Ku janë ato femra femra deli femra?  
Ku janë ata meshkuj me një teste zemra?  
Njëri muri lisi, tjetri musi shkëmbi,  
më së fundi mortja erdhi e i shëmbi!*

*Ku është' Fejzo Xhafua, dif i vëndit tënë?  
Rrapua i Hekalit, burrë i ler' me hënë?  
Çelua i Picarit, Çelua i Athinës,  
krismat e rrufeve, gjëmë e suferinës?*

*E ku është' Gjoleka, kryetrim i Kuçe?  
E ku jan' këmishat përmbi gju hajduçe?  
E ku është' xhyzdani, folla e pallaska?  
Pa këto arbreshi fare hije s'paska!*

*Tepër dredharake qënka kjo jallane,  
E ku janë ajanët burrat hane hane,  
pleqësi e vëndit veshur me fustane?  
Veshur me fustane, hej... fustan' e shkretë...  
humbën parësia, humbe dhe ti vetë,  
lisit të gremisur më s'i mbeti fletë!*

**VI**

*S'mbeti bor' në male, bora paska shkrirë;  
s'mbeti uj' në fusha, ujët paska ngrirë!  
Fusha paska dimër, mali paska vapë,  
sqifi dhe sorkadhi humbi krah e çapë*

*Mu në mes na theu dynjallëku i shkretë,  
nuk na mbetën lule, nuk na mbetën fletë;  
fletët na kan' rar', pëndët na kan' rar!,  
nuk na peshon bota fare në kandar!*

*S'mbeti derë e hapur, humbi salltaneti,  
humbën zijafetet, humbi muhabeti.  
Plasën duke thirrur rroft' e qoft' mileti,  
që të rroj' mileti, u bë kijameti!  
ja, edhe mileti nashti u bë popull  
dhe nga sherr i tia mëndja na vjen rrotull!*

*Populli si deshi bëri një kanun  
që t'i thotë agait bujku: !si ti, un'!"  
Si ti, un' , moj motër, dhe s'ta ka për pes',  
breh Valia i Korçës fare dinglemes,  
i zoti hostenit vjen e të merr pjes'  
i zoti fermanit mbet me duar në mes!*

*Musi lesh arapi bota u trazua,  
duaxhiu i djeshëm sot na u harbua,  
jo vetëm ha bukën përmbys kupën  
po guxon e dashka dhe për grua çupën!*

## VII

*Mbylle, më thon! djemt', tepër plak njeriu  
bënet mëndjevogël mu si çilimiu,  
qënka si çdo plak,  
ena pa kapak!*

*Mirpo un' s'jam plakë, memur i harbuar  
shtatdhjetë e dy vjeçë vajti më ka shkruar,  
Unë e mbaj mënd mirë, isha goxha keçe,  
kur u bëra nuse isha njëzet vjeçe;  
rrojta e martuar dyzet e dy vjet  
dhe tridhjet ka burri që ndërroi jet',  
bëni mir' hesapin, dale me ngadalë,  
ky harbut memur rrenacak do dalë!*

*Më par' kishim hoxhët me divit në bres,  
shkruanin mbarë e bukur, shkruanin me kujdes  
jo vetëm deftera po edhe duara,  
doktor e receta s'kish në koh' të para!*

Me këto receta, me këto gënjeshtër  
u helmua gjaku, u helmua eshtra;  
zjarr në zëmër s'mbeti, vajti e u shua,  
dale me ngadale burri u bë grua!

E ku qënka parë, e ku është dëgjuar  
që të hapi fëmra gji e hrahuar  
dhe të shkoj përpara, burri t'i vej' prapa,  
ky pa hedhur çapën, femra hedh tri çapa?

Nuk i merr kalemi gjith' këto hesape,  
kur që dora e burrit futet në çarape  
llërë e gruas dolli lakuriq në shesh...  
Gjen shejtani shesh edhe bën përshesh!

### VIII

Mir' për na të parët s'mbeti fjalë e vënd'  
brez'i ri vall' ç'pati, që u prish nga mënd?  
Gjeti çar nuk gjeti, pati çar nuk pati  
amanet nga nëna, amanet nga ati  
gjithë ato zakone, gjithë ato zanate,  
gjithë ato që ishin burime, irate,  
si ato të burrit dhe ato të femrës  
thellë e thell' rrënjosur mu në thelp të zemrës  
dhe për vëndin ishin eshkë edhe stërrall,  
që në gji të burrit zjarrë e mbajnë gjall',



*Ali Asllani*

*zjarrin e arbreshit, zjarrin që ka pasur,  
me atë që botës buzën i ka plasur;  
zjarrin e arbreshit, zjarrin e vatanit,  
zjarrin që bën vëndin vënd të jataganit!  
sidomos, moj motra, punën e tezgjahut,  
që punonin zonjat me fuqinë e krahut,  
me djersën e ballit,  
punra që tregonin shpirtin e të gjallit:  
guna e mëngore, linja e jelekë,  
leshin na i çonte stan i deles bejkë;  
gjithë ato që ishin prokopi e tija,  
dhe përhera mbahej shtëpi e fëmija,  
gjithë ato që thoshin "jemi gjithë arbresh"  
keq a mir' të ishin dhe kudo të jesh  
një nga një i hodhëm mu si gun' të grisur,  
deh, moj kokë e krisur, puna e mavrisur!*

*Një nga një i hodhëm mu si gun' të vjetër  
dhe nuk qem' të zotët që të bënim tjetër,  
papo mbetëm drangull.... në shi e në djell,  
mbytur nëpër halle thell' edhe më thell'.*

*Mbytur nëpër halle si një frëng myflis  
me një pallto kashte hedhur mbi kurris,  
dhe një palo shapkë me një pa' shallvare  
dhe më keq akoma, që nuk vete fare,  
veshur benevrecke ose një poture  
dhe në rrip të mezit varur një kobure!*



*Jemi bër', moj motra, ç'far' të them nuk di,  
gjysma e trupit zok, gjysma e trupit mi!*

## **IX**

*Ku janë ato kohra, kohra të ergjëndit  
kur na sillej qjelli si baba' i vëndit?  
Po ashtu dhe shium po ashtu dhe djelli  
kurse na i deshim binin që nga qjelli;  
me të hapur gojnë qjelli na i çonte  
mu në mes të vapës shi flori pikonte!*

*Ku janë ato kohra, kohra të ergjëndit,  
që dhe hëna sillej mu si nënë e vëndit?  
Pra dhe beja bënej po për atë hënë,  
po për atë nënë,  
për diell e për qiell,  
dhe për atë zot q'është' më i thell'!*

*Nashti kur betonet burri thot': "për nder"  
be e par' dhe feja mbeti pa një vler';  
bota u çkallmua, puna u trazua,  
burri u bë grua, femra u harbua,  
hoxha u bë prift, prifti u tërbua  
dhe, gjynah mos qoftë, bënen mish e thua!  
Vera u bë dimër, dimri u bë bishë,  
shiu na i kalbi mish edhe këmishë!*

Gjëja më e vyer mbeti pa një vler',  
e, pra, hunda e botës duhej pakëz thyer...

Edhe mirë u thye,  
pa kapell' në krye  
mu si njeri pylli,  
del e shëtiti burri...

Vdiqën duke qeshur turku dhe kauri!  
Çdo gjë e ka humbur, humbi dhe pusullën,  
s'ka në dorë as kokën që të vër' kësulën!

**X**

Korr atë që mbolle, thënka fjala e vjetër,  
Ja, nga anë e zotit dhe një vrejti tjetër:  
vinte ramazani, dimër qoftë o verë,  
kthenej nga Qabeja hëna me një herë!  
Nashti edhe hëna zuri shikon vrëngër,  
pasi kemi ndjekur udhën më të shtrëmbër!

Pa vështroni hoxhët, që aty më parë  
shkruanin si desh'zoti, me kalem të mbarë,  
vinin nga e djathta, venin në të mëngjër,  
nashti, t'i hajë ujku, zunë e shkruajn' shtrëmbër!

Gjith' këto gjynahe nuk i lan as deti,  
duket që afroji koha e kijametit.

*Thënka dhe qitabi: robi kësaj jete  
dale me gadale nuk do jet' në vete,  
sa që do harrojë portën e gjitonit,  
sa që do pështetet degës së rignonit!*

## XI

*Halla aty heshti, hoqi thell' në zemër,  
diçka iu kujtua, sikurse një ëndër...  
Një kujtim i vjetër erdhi e qëlloi,  
si një yll i djegur flakë e fill kaloi!  
"Ai" i kujtonet, veshur me fustane,  
në një dor'tespijet vark e radh' merxhane,  
dhe në dorën tjetër një çibuk sermaje  
rrahur me sedefe, gurë qehribaje!  
Vula dhe sahati varur përmbi gryk'  
dhe mbi supe hedhur atë goxha qyrk.  
Dredhur dhe mustaqet, dredhur e përdredhur,  
brënda në silahe dy pisqolla kredhur  
kredhur dy pisqolla dhe harbinë e artë,  
shpatullat një pash, koka atje lartë,  
varet nga haremet, zbret në rapanara,  
zapanatë e shkreta, zapanatë e para!*

*Kur ja hipte kali, kalit qyhelan  
edhe shkon revan  
edhe qahjaj pas*

*me një dor'në vithe... zëmra fryhej gas!  
Kali si drangua,  
katër vetëtima shkrepse një potkua!*

*Ah'- thot' Hanko Halla, - kur ish "Ai" gjallë  
kurr' nuk bënte "gëk" njeri në mëhallë! -  
"Ai" - na thot' Halla, - pasi femra kurrë  
s'mund t'i flas' në emër burrit që ka burrë!*

## XII

*Tym e re e mjegull dhe në mes të saj  
çquan një drit'kandili terur e pa vaj...  
Çquan një dritë e varfër, çquan një dritë e shkret'.*

*s'ka fuqi të digjet, ka fuqi të vret,  
si një sy i bukur, flakë e lot shteruar  
gati për t'u mbyllur, gati për t'u shuar!*

*Ç'do kujtim i ëmbël po kështu na duket  
kurse ditë e jetës ngryset edhe muket,  
Kurse dit' e jetës iku e u ngryset,  
duket sikur bota vajti u përmbys!*

*E... çfarë është kjo jetë? Nuk e di kush thënka,  
qënka mos na qënka, një kujtim na qënka:  
Vdiqe - të qan tjetri, linde - do qaç vetë,  
midis të dy lotve një kujtim i shkretë!*

## **Pjesa e dytë**

I

*Hallës nuk i hahet, Hallës nuk i pihet,  
me të renë e saja fare s'po i kihet.  
Nusen nuk e dashka sa në od' s'e qaska  
dhe qëkurse erdhi hal' në sy e paska!*

*Dhe qëkurse erdhi Halla paska thënë:  
NUk më duket nusja nuse për të qënë.  
Lum shtëpi e babës diti dhe e nxori,  
mjer shtëpi e burrit ra në lak e mori!*

*Tani - vazhdon Halla - si do t'ja bëj hallit?  
Çfar' t'i zemanit, pa për sy të ballit,  
do t'i thoshja djalit jepi tek e hak  
edhe ktheje prapa, bosh me tre tallak!  
Shko andej nga erdhe, erdhe kot së koti,  
se paraja kallpe vete te i zoti!*

*Çar' tí bësh zemanit, shum' zeman i keq,  
shum i rënd' për plaka, shum' i rënd' për pleq.*

Hoxha nuk trazohet, kadi nuk na mbeti,  
me të tilla femra hall i madh na gjeti!  
Hall i madh me nuse, hall i madh me çupa,  
një lëkur kunadhe hedhur përmbi supa  
tunden dhe lëkunden dhe në mes këputen,  
nëpër duar të shkasën, po në zëmra futen!

Punë e tyre vetëm: lahen edhe lyhen,  
edhe nëpër valle venë e vinë e thyhen;  
femra me një mashkull, vallja vetë i dytë,  
plasur delli ballit, më u plaçin sytë!  
Gjith' me flok' të prera  
jo alla garsonë, jo alla bebera,  
me një llër të freskët nëpër djell të thekur,  
me një trup të zeshkët nëpër kum të pjekur,  
gji e gusha hapur digjen ylyver  
me një mes të hollë gati për t'u thyer.  
Me një buz'të kuqe shumë e shumë të nxehur  
dhe me atë vetull tej për tej të prehur,  
me ato vështrime mu sikur të lutet  
ngjan se halle madhes shpirti i këputet;  
me ato kapele varur gjer në vesh,  
zjarri i xhehnemit doli krejt në shesh!

Jo, moj xhane, kurrë s'mundem që t'a heq  
që të thon' se nusja ka një huq të keq;  
na flë e na ngrihet kur asaj i teket!  
dhe i bën qepallet sikur qan e meket!



*Ali Asllani*

*Brënda s'e mban vëndi, ngjan se u çkallos,  
jasht' nashkon përpara si një korcollos;  
me ditë e me orë zgjatet e mbufatet  
me hije të saja afër darkës matet!*

II

*Nuse e kësaj kohe tjetër zanat s'paska,  
a do marr'kalemin, që të bëj' laraska,  
a do zër' të shkruaj' ose do dëgjojë  
një kuti të vogël që na flet me gojë.  
Një kuti të vogël që mos qoft' të jet',  
është'një frëng i marrë, çirret e bërtet!*

*Me një biz' në dorë bën sikur punon,  
këmbën përmbi këmbë nusja e dëgjon;  
dhe çudi, moj motër, si e qysh duron!  
Duket nga një herë zëri e lëndon,  
frëngu rri i qetë ose do bërtas',  
nusja e humbet dhe i vete pas,  
frëngu e ngrë zërin edhe sokëllin  
nusja e lë për in edhe vërshëllin;  
ai flet me vete, flet e flet përçartë  
nusja s'është në vete, bënet më e zjarrtë!*



III

Halla do një nuse, nuse goja plotë,  
si një zall të bardhë, si një zall të fortë,  
me shami në krye anë e mban'qëndisur  
dhe me flok'të gjata prapa arratisur;  
dhe me flok'të gjata deri mu në mes  
mu si nat' janari, sa të thell'të zes;  
me shami të hollë ballë e faqe hedhur,  
sa t'i duket syri në qepalle kredhur;  
me flo në gushë hapur mu si prush,  
si t'ju them, moj motra... pjergulla me rrush!

Rrallë e tek të duket, rrallë e tek të flas',  
një thëllëzë e bukur mbyllur në kafaz,  
mbyllur në kafaz një thëllëzë e bukur,  
mu në mes të reve hëna në të dukur,  
mu në mes të reve si hënë e si yll  
ose si një xinde fshehur në një pyll!

Halla do një nuse si edhe i biri  
rrënjët prej ergjëndi, degat prej floriri  
me të folur Halla, nusja të hap'sytë  
"Lepe" fjala e parë, !peqe" fjala e dytë;  
edhe asgjë tjetër, vetëm "lepe", "peqe",  
pasi zemra e Hallës qënka si një qelqe:  
po u thye, vajti, e s'ka më: ngjite, qepe,  
zogu i plagosur di të kap' me sqepe!

IV

Çupa - tregon Halla - nuk stoliset fare  
që ta njohën bota zogëzën beqare;  
po kur bënet nuse, nusja do të niset  
me fletë, me lule pema do stoliset!

Dora me kënah, koka me mazi,  
dhe në cep të syrit një gjëkafsh të zi,  
“sevap” e “xhaiz” është ca pika erë  
sa t'i njom' cullufet freskë e bukur prerë!

Hajde dhe shaminë, sado është gjynah,  
lere që ta lidhi shtrëmbër në një krah!  
Po të sillet bukur si dhe gratë e para,  
sidomos - thot Halla - dua temenara!

Temena e shkretë humbi si një ëndër,  
vjen të merr nga sheshi dhe të vë në zemër,  
pasandaj në buzë, mbasandaj në kokë  
aty ku është' vëndi për miqtë e për shoqe,  
kurse nashti femra, kokërr në karroqe,  
vjen ta bën me kokë, pasi tash pothuaj  
na e bën frëngesha brënda disa muaj!

*“Me një herë u bëmë  
Zoti ja baftrëngut shapkën sa një lëmë”  
thanë edhe u derdhën, rafsha mos u vrafsha,  
merr e bjer për dita rroba të mëndafsha,  
rroba t mëndafsha, rroba kashtë e bar,  
nusja për një manto jep dy grushte ar!*

*Gjith' pazarin nusja mu në odë e futi,  
na u bë shtëpia nagazi çifuti;  
rroba për pasdreke, rroba për mëngjes,  
rroba për një mjegull, rroba për në ves',  
disa për në banjo, disa për në kum,  
disa kur t'ia bëjë një daulle bum;  
disa për në çajra, disa për në valle,  
ruana zot dhe rroba për në karnavale!  
Disa për në dimër, disa për në verë,  
tamam sa për vjehrën që të fryhet vrerë!*

## **V**

*Mir'se mëndjeshkurtër fëmra u harbua,  
burri që është burrë ç'ka që bënet grua?  
Çdo gjë ka të ngjarë, por kurrë edhe kurrë  
dorën e një fëmre nuk e puth një burrë!*

Pa më thoni, zonja, si ka ~~e~~ e faqe,  
si mundet e bënet mashkull pa mustaqe.  
Kurse be e burrit, beja më me hije  
dora në mustaqe bënej deri dije,  
dora në mustaqe edhe mos u tund  
pasi fjalë e burrit aty merrte fund!

Çdo gjë u ndryshua, çdo gjë u shkallmua,  
koka u zbulua, këmba u mbulua,  
kur në kohrat tona, me të hyr' që hyje,  
kundra mbetj jashtë, festja përmbi krye;  
nashti futet brënda çdo këpucë e ljer  
dhe kapelë e pastër varet përmbi derë!

## **Pjesa e tretë**

I

*Halla paska pritur me them" e të thash',  
sa u rrit shelegu edhe u bë lash;  
nusja, ajo nuse, ndiz e fal cingar,  
më shum' nga cingari nusja merret zjarr!*

*Nusja, ajo nuse... ari i shtëpis'  
bëri këmbë e iku, xhepi u vithis.  
Ari i shtëpis' bëri këmbë e iku  
kur një nat' pas darke, një kokosh: kikikul!*

*Ish kokosh i Hallës, një kokosh i bardhë,  
një kokosh që shokve nujk iu linte radhë,  
kur ja thosh'i shkreti hipur përmbi shkallë,  
zëri i tij, moj motër, ruante shtat' mëhallë!*

*atë nat' - thot Halla - bëri zë pa kohë,  
na u prish dhe moti bëri shi e llojë,  
koha u ndryshua, moda u ndryshua,  
"Dua dy pal'rroba" nusja u harbua,*

*njërën e do klosh, tjetrën ohohosh,  
zuri borxh'n e parë dy mijë e ca grosh!*

**II**

*Një dit, më thosh'nusja, gjëra për të qeshur,  
sa më ra prej krahut dhe këmisha e veshur:  
"Hall" në ke të holla mbetur a kursyer,  
leri në një bankë'vëndi më i vyer!"*

*Nuk e dinte nusja fjalën e të parit:  
- haje, o i mënçur, mallin e të marrit. -  
Ari, bija ime, ari i kursyer  
vëndin e ka bukur brenda në qemer!*

*Me të thirrur: xhep!  
xhepi të thot': lep!*

*Ari në qemer, foshnja përmbi bel,  
na i tha i pari që shikonte thell'!*

*Ka edhe të tjera, fjalë q'i merr era,  
mirpo nga një herë nuk i nxë as dera.*

*Ç'pret nga brez'i ri?  
Gjëja më çudi s'quhet më çudi!*

*Nusja paska parë në qitap të ri  
që përpara ligjit jemi një lloji,*

*edhe un', moj motër, zëre nga tá zësh,  
me këdo një grua qënkam një e njësh!*

*Mirë i thash, moj bijë, po qitap i vjetër  
thënka një gjë tjetër:  
Syri do t'i plasë, dora do t'i thyhet  
dora e mameshës që s'ju preu kryet  
dhe ju la bela,  
zjarr në xhep për burra, hal! në sy për gra!  
Nashti jam mësuar  
mu si majë e malit me dëbor ngarkuar!*

### III

*Halla thot' të drejtën: nusja kur të flasë  
para Hanko Hallës, fjalët mir' t'i masë;  
nusja eci mëngjër ose shikoi vrëngër,  
s'ka të bëj', se Halla, ka një deli zemër.  
Femra në ka një, Halla na ka dy,  
dhe sado që fajin bam ta thot' në sy,  
sa her' na ka falur! Nusja na lajthitet,  
koka e falur s'pritet!*

*Të rinjtë e të rejat jan' si ditë prilli,  
rriten dita ditës dhe si trëndafili  
herë i deh bilbili, herë i deh veriu,*

*her' po kot së koti dehen vetvetiu.*

*I riu veriu thënka dhe i pari,*

*fjala e të parit vlen më shumë se ari!*

*Nusja paska prishur, lere që të prishë,*

*nusje e Hanko Hallës lindi me këmishë,*

*pasi derë e Hallës është burim kismetit,*

*dhe kismetit saja vjen si vala deti...*

*Në se mbaron njërim rrjedh e vjen një tjetër*

*dera është e hapur në shtëpi të vjetër!*

*Si e re që është edhe nus'e Hallës*

*derdhet mu si vala, vala i ngjan valës;*

*po sado të derdhet mu si valë e detit*

*nonjë dëm s'i bënet detit e kismetit!*

*Shkoni e shikoni valën që valon,*

*se sa shumë gjëmon, se sa pak gjykon;*

*me re e me erë zë e guduliset*

*tundet e lëkundet dhe nga shtrati niset;*

*fryhet edhe fryhet duke ngritur kryet,*

*pasandaj i teket anës deti thyhet;*

*njëra shkon përpara, tjetra turret pas,*

*njëra do përplasët, tjetra do pëlças';*

*si e si të bëjmë sa shumë e më shumë*

*mbi kurriz të detit buj e zhurmë e shkumë!*



*Mirpo deti - det  
dhe asgjë s'humbet!  
Dhe, sado që duket se u bë rrëmujë,  
deti si përhera rrafsh e plot me ujë!*

## **Pjesa e katërt**

I

*Shpirt e xhanë,  
eja, më thot' nipi, vemi në Tiranë,  
Eja, Hall', të lutem, se do vësh sehir  
zonja shum'të mira, burra shum'të mir'!*

*Lem, të keqen Halla, ti më rruash të paça  
un'për her'të fundit do të dal, në dalça;  
e do dal, do iki dhe do shkoj për jetë  
në sehir'të fundit, në sehir'të shkretë!*

*Un' mor djal' i Hallës, nëna e shtëpisë,  
kam një tuf'me halle varur mbi kurriz;  
kam një tuf'me derte, kam një tuf'me halle  
nga ato që zbardhën vetull e qepalle;  
e i thash'i thashë...Djali, me shum' mall,  
eja, nguli këmbët, xhan'e shpirt, o Hall'!*

*Desha dhe nuk desha,  
Hodha namazbezin, mirë e mirë u vasha,*

dhe që atë ditë hipëm në kaike,  
ish për her'të parë që po veja mike,  
mike në pampor;  
prita edhe prita, po sa prita s'di,  
mbase nonjë orë,  
si i thon' nashti

Pasi dhe sahatin, sahatin e gjorë,  
që kur na e prishën edhe e bënë orë,  
- na u bë dhe koha fare li e lesh, -  
sahatin e saktë nuk po e marr vesh!

Prita në pampor, prita kot së koti;  
as e zonja erdhi as edhe i zoti;  
"mirserdhe, moj zonjë" njeri nuk më tha,  
frëngun dhe frëngeshën ujku që s'i ha!

Un' , thot Hanko Halla, sado që kam rar'  
matem e peshonem me flori e ar;  
na jemi si rrëza, mu si rrëza e djellit,  
që sado që bije lart nga maja e qiellit,  
bije nëpër male, krahu nuk i thyhet,  
bije në moçale, këmba nuk i lyhet!

||

*Pasandaj pampori fryti e u nis;  
si kërsacin muret, muret e shtëpis',  
si karcasin muret, kur i rreh tërmeti,  
po ashtu kërcisnin kur i rrihte deti  
eshtrat e pamporit; mirpo më së fundi  
diti si e tundi!*

*Kur i vinte vala, bënte sikur kridhej,  
kurse valës tjetër drejt për drejt i hidhej;  
aty valës dukej anës do ja mbante,  
kurse valën tjetër mes për mes e çante!*

*Ballë i bëri bukur detit të tërbuar,  
një dybek i rrihte mu në kraharuar;  
dank e dunk dybeku... un'sa jesh' kumbisur  
kur dëgjoj ca pula tue kakarisur!*

*Tepër u habita, qën kemi në Vlorë  
apo harroj udhën ky i shkret pampor  
dhe u kthye prapa? Po në mbeçim udhës?  
Kur dëgjoj që thoshin: "kena mrrri në Durrës!"*

*Që thoni, moj zonja, erdhëm në Tiran',  
po kur disa femra, m'u bëfshin kurban  
disa qyqe femra më një qoshe mbledhur  
ferexhet e zeza përmbi krye hedhur,*

*koka e mbuluar, këmba e zbuluar,  
ruana zot nga fëmra kurse ka çkalluar!*

*Thon' se nga një herë këto ferexhera  
diku i ngrë era,  
brënda duket zoga ballë e gush' flori  
që i thot Tirana "zogëza kumri!;  
qënka guguftuja që i themi na,  
mirpo është'gjynah, s'mundet "me u pa"!*

*Afër disa meshkuj, veshur, - po si veshur? -  
disa për të qarë, disa për të qeshur;  
në krye në këmbë pa shije pa hije,  
çfar'tju them, moj motra, pika që s'u bije!*

*Disa për të qeshur, disa për të qarë,  
s'paska më shqiptarka, s'paska më shqiptarë!  
Ku janë ato rroba, rrobat e të parit,  
rrobat që peshohen mer derhem të arit?*

*Tej një shesh i gjerë bota jep e merr,  
edhe një gjëlpërë s'ka se ku të bjer';  
zonja e zonjushë, si thëllëza fushe.  
mu si pika ari, mu si flori gushe;  
dy nga dy po ecin me bërryle shtyhen,  
në se u heth dorën, ne një her'do thyhen!*

*Me një her' do thyhet mez'i hollë i vajzës,  
shkon për mes të rrethir, rrethit të unazës;  
hedhur si lastare, hedhur si billonja;  
zonja mu si çupa, çupat mu si zonja;  
palët mu si valët, shkon e vjen një tjetër,  
duket thanë e kuqe edhe femr' e vjetër!*

III

*Blegërin një dele, tingëllim një zile,  
bota paska halle, hallet me kaçile;  
hallet me kaçile, halle prej Tirane,  
lum Tiran'e kuqe mbushur me zeshkane!*

*Mirëpo - vazhdon Halla pakëz e çuditur,  
rri si sorkadhja, çap e vrap lajthitur -  
mirpo ra mëngjezi, rrugët do i masën,  
erdhi darka vjehrës, buzën i pëllcasën;  
lozën edhe karta, birçe ose briç  
çekan e çekiç në kokë e godiç.*

*Folu, nuk të flasën; ktheu, zën e shkasën  
dhe me cep të syrit din' se si të vrasën.  
Dhe ajo që duket engjëllushë e butë  
në një shishe brënda dy shejtane futë;  
llëra lakuriq këmba lakuriq,  
demek sa për mua... edhe burri vdiq;*

**IV**

*Hanko Halla isha. Hanko Halla jam,  
Hal'në sy i kisha, hal'në sy i kam.  
Nuk më mbushet syri, nuk më mbushet zemra,  
nuk më piqet ylli me të tilla femra!*

*Mirpo - vazhdon Halla edhe psherëtimi, -  
aty nga del fjala, do më dal'dhe shpirti;  
pra, do them të drejtën, se më bënet derte,  
cilido gjynahun le ta ket'për vete,  
kur i pash'të parat, desh më zuri frika,  
kur i pash'të dytat...deh iu rëntë pika!*

*Ato që mos qofshin, këto për të qënë...  
duket pem'e bukur, që ka mbir'me hënë;  
duket pem' e bukur, që me hën' ka mbirë  
dhe që asaj dite ish sahat i mirë:  
porosita djalin: - Në se të kam djalë,  
ik e i thuaj nuses të m'a bëj' hallallë!*

**V**

Aty Halla heshti, hoqi psherëtiti,  
një kujtim i vjetër erdhi e goditi...  
Kur ish Hanko Halla huse top'i borës  
kur "Ai" e mbante në pëllëmb' të dorës,  
vishej edhe ngjishej sikurse një flutur,  
sikurse një flutur nëpër fleta futur!

Sako dhe tumane... ar dhe mëndafsh,  
varur pendolirat... shko një her', më qafsh...  
shkonte si veri e vinte si tal'as,  
këmba, si krah zogu, s'linte gjurma pas!

Halla ish një lule dhe nga ato lule,  
syri me ta parë, mu në gjunj u ule.  
Ajo ish një lule, po edhe "Ai"  
ish për atë lule një saksi flori,  
Fund' i flajës Halla ish një dallandyshe,  
si ish e si qënka... jan' dy gjëra ndryshe!



## **Nusja që do halla**

*Nusja, nuse pullumbeshë  
na u vesh e na u ngjeshë  
me ato hane hane  
vishen kankot hanedane,*

*me ato gazep tumane,  
me xhanfes e me atllase,  
një tumame shtat' tallaze,  
shtatëdhjet' e shtatë naze!*

*Përmbi supe një kaftan  
gjith' inxhi e gjith' merxhan  
hipur kalit qyhejlan,  
përmbi shalë gjith'sadefe  
të qëndisur me gjergjefe  
e përциell me dyzet defe,  
dhe me katërqind kalorës  
niset bij' e rënd' e Vlorës!*

*Paj' e sája teste teste  
nga takija gjer në meste,  
që nga mestja në takije  
njëzet vargje mahmudije,  
kollonata, mexhidije...  
mexhidije, kollonata,  
një vandak para të thata:  
dhe si xhika, tri me radhë  
dy esmerka një e bardhë:  
dhe në krye një duvak,  
mbyllur brenda një zambak!  
Një duvak i kuq me xhufka  
rrotull turka dhe kaurka!*

*Nëpër rrugët e qytetit  
Zjen muzik' e Hyqymetit,  
zjejnë defet e miletit.*

*Dhe në rrugët e mëhallës  
duaxhit e Hanko Hallës  
me memur e me memurka,  
ca sojlesha, ca harbutka,*

*Po, natën e parë nusja jon'sorkadhe  
duhet që të flerë me Hankon e madhe,  
dhe natën e dytë me një hanko tjetër  
me Hankon e Mesme hanedank' e vjetër,  
me Hankon e vogël në të tretën natë,  
duket nus'e Halles që ka ler' me fat!*

**Hanko Halla**  
**Hanko Halla!**

*Hanko halla, Hanko halla!  
nga do zëre që ta zësh',  
tani thonë e gjith' mëhalla  
me ty qënkan një e njësh'!*

*Dhe ky nip besnik, që pate  
që në ujë i ndizte pushka;  
tash për kok'të zotris' sate  
nuk i flet me gojë as krushka!*

*Ishim tjetër, u bëm tjetër,  
qoft'me hir o qoft' pa hir  
heshti kënga e korit vjetër,  
hyrë e dil e tund peshqir!*

*Dikur lopët e mëhallës  
s'mund të pinin uj' më parë  
pa mos ardhur lopë e hallës  
e përcjell' me dy loparë!*

*Po nashti na humbi vula,  
dualnë zoqtë nga furriku  
dhe këto të reja pula  
u bën gjela tash, kikiku!*

*Hyjënesha e floririt,  
zonjë e madhe milionerkë,  
tash, në vënd të xhevahirit,  
në gryk'vari një piperkë!*

*Me dor'shkence tej për tej  
u bë vashëz dhe vejushka,  
s'është çudi që nesër-dej  
të na pjelli edhe mushka!*

## **Përmbajtje**

<b>MIKU I TË GJITHËVE, ALI ASLLANI .....</b>	<b>5</b>
<b>Pak biografi .....</b>	<b>15</b>

### *VAREN ESHTRAT E SHQIPTARËVE NËPËR SQEPAT E SQIFTERIT*

Dëshpërim dhe shpresë .....	21
Varrimi i Ismail Qemalit .....	24
Buza ime kur do qeshë? .....	27
Kush mban armë të ergjënda .....	29
Vlora, Vlora! .....	33
Flamurit kombëtar .....	35
Vlora .....	38
Mir'se ardhët! .....	40
Ah ky vend... ..	42
Vajza shqiptare .....	45
Mbani kokat atje sipër .....	49
7 Prill 1939 .....	50
Dasma e madhe .....	52
Ali Pashë Tepelena .....	55
Fshati dhe Perlati .....	58
Perlat Rexhepi .....	60
Një flamë .....	62

Qeveria është'e pashës...	64
Ja programi im ështëë ky .....	66
Dëshira e Labit .....	68
Okupatorëve .....	70
Hakërrim .....	72
Koka bën e koka vuan.....	77
Imam Efendiu .....	80
Koha jonë, i dashur mik... ..	82
Nastradini- Musolini .....	84
Nastradini u bë saraf .....	85
U betova një ditë rëndë.....	87
Xhaxho .....	89
Që kurse u prish dynjana... ..	91
Zonja Lu .....	93
Fshati Vajzë .....	98

### *GU-GU, GU-GU, GUGUFTU*

Kujtimi yt .....	104
Vajzat heqin valle .....	106
Vajzat dhe dallënyshet .....	108
Pyeta valët vogëlushe .....	110
Një vështrim i arratisur... ..	112
Mbi qepallat më trokit .....	114
Çupëz moj çupëzë.....	116
Jo, jo, sonte mendoj ndryshe... ..	120
Mos më duaj tashi e tutje.....	122